



"SHENDETI" ► Faqe 13-17
Acidi Larixic çon kancerin në "vetëvrasje"



In memoriam
"Kthehet" Aleko Prodani, "Bëra shaka"
 ► Faqe 20



Portret
Kështjella e Jozefinës
 NGA EDMOND ARIZAJ
 ► Faqe 7

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi SHENDETI VITI III - NR. 71 E enjte, 28-03-2013

Fjalëkryqet e fundit nga Kadri Vokopola
 Faqe 23

PROPOZIMI NE KABINET

Kreu i Qeverisë kundër vendimit të dy viteve më parë për automjetet e vjetra

TERHIQET BERISHA

KRYEMINISTRI PERGJYSMON TAKSEN E MAKINAVE

"Nuk mund të penalizojmë qytetarët, sepse del që ai që ka, ndihmohet dhe ai që nuk ka, ndëshkohet. Kjo nuk mund të pranohet" ► Faqe 2-3

VENDIMI ► Faqe 22




Emiljano Shullazi sot në Apelin e Shkodrës, pritët masa

SHENDETESIA ► Faqe 6



Infermieret përplasën Berishën me Ramën
Kryeministri: Nuk janë shtëpi publike. Kreu i PS: Hajde në debat

Një kafe me doktorin...



NGA ANILA BASHA
Po në fakt, ç'do gjë kalon nga krevati?

Më duhet të them që në krye të herës se për një kohë të gjatë komunikimi im me doktorin ka mbetur në vend. Doja të shkoja ta takoja javën e kaluar, por u frikësova shumë nga gjithë ajo batore sulmesh që me apo pa të drejtë... ► vijon në faqe 12

Koment
 NGA ARDIAN NDRICA

Kushi dhe Kurrkushi

Nuk kam asnjë ide se kush asht zonja Evis Kushi, kandidatja e saposhpallur e Edi Ramës për Qarkun e Elbasanit, por jam i bindur se po të kishte qenë një si puna e do pulave pa krye që kokorisin në kotecin e PD-së, s'do të ishte marrë kush me të. Speaker-ja e Parlamentit, aktiviteti kryesor i së cilës, përposë... ► vijon në faqe 12

SOT VOTIMI NE KUVEND

Nishani kundër PD: Gjyqtarët sipas ligjit

Reagon Presidenti pas kundërshtimit të Qeverisë. Deputetët, dyshime për emrat e parë



TIRANE
 ARTEMISA HOXHA
 Dekretet e presidentit Nishani lidhur me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë do të... ► Faqe 6

NERANXI
 ... gjithmonë një hap përpara...
Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.

GRIMCA URBANE ► Faqe 12
 PUNË KAFENESH...
 NGA EVIS CERGA

Gërdec, qeveria pagan me vonesë dëmet e banorëve

Pesë vjet pas shpërthimit të qendrës së demontimit në Gërdec, qeveria vijon të paguajë dëmet e shkaktuara banorëve të zonave përreth, me paratë e taksapaguesve. Në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Ministrave është marrë vendimi që Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2013, t'i akordohet fondi shtesë prej 13.018.800 lekësh të reja, për dhënie ndihme financiare

familjeve të dëmtuara nga "aksidenti teknologjik" i datës 15 mars 2008 në fshatin Gërdec. Kjo shumë do të shkojë për pagesën e qirave të banesave të të mbeturve pa strehë, si pasojë e prishjes së banesave të tyre, si dhe në formë dëmshpërblimi për dëmet e shkaktuara nga mospërdorimi i tokave e kulturave bujqësore, që ndodhen brenda perimetrit 300 metrash

rreth kraterit, zonë, që është shpallur si "zonë e sigurisë së lartë" dhe praktikisht vijon të mbetet e pabanueshme dhe e papërshtatshme si tokë bujqësore. Këto qira e këto dëme po paguhet me vonesë nga qeveria, pasi u takojnë viteve 2011 dhe 2012. Fondi në fjalë, ekuivalent i rreth 93 mijë eurove, duhet të përballohet nga fondet rezervë i Këshillit të Ministrave.

Pas dy vitesh, Berisha propozon përgjysmimin

Qeveria korrigjon taksën e makinave

Rishikohet sërish sistemi i taksave

Lajmi

Kryeministri Berisha ka njoftuar dje përgatitjen e qeverisë për ndryshim të sistemit të taksave nacionale, konkretisht përgjysmimin e taksës vjetore për automjetet e përdorura, një dështim i rradhës i politikave fiskale



Sali Berisha dhe Ridvan Bode

Reformat

Kur është miratuar taksë vjetore në fuqi për automjetet në Shqipëri, ka qenë i njëjti kryeministër, i cili e ka cilësuar si një "akt të shkëlqyer" edhe atë, që tani po e hedh poshtë, si "më të avancuar edhe se në vendet e BE-së"



Dështimi

Më 2011, u hoq taksë e rishitjes së makinave

Përpara se të rishikojë taksën vjetore të makinave, qeveria ka pranuar dështimin edhe për një taksë tjetër. Në korrik të 2011-ës, ka qenë ministri i Financave Ridvan Bode, që ka deklaruar se taksë e vendosur për rishitjen e mjeteve të përdorura nuk solli rezultatet e dëshiruara. Nga 2.883 mjete që kishin ndryshuar pronësinë në një vit, kur taksë qendroi në fuqi, vetëm 1.146 mjete iu nënshtruan taksës së mjeteve të përdorura. Ulja e numrit të ndryshimeve të pronësisë çoi në rritjen artificiale të mjeteve që qarkullojnë me akte përdorimi, pra pa ndryshuar pronësinë mbi to. Kjo çoi në mosnjohjen e pronarëve të vërtetë të mjeteve rrugore, sipas ministrit, që paraqiti një projektligj në Kuvend, duke shprehur me këtë rast "me culpa"-n e tij pse nuk ishin thelluar në pasojat e vendosjes së një taksë të tillë.



lartë në vend. Por mjeti i gjetur nuk i shërbeu qëllimit, përballë një evazioni masiv, të nxitur nga korrupsioni i administratës tatimore.

Në vitin 2011 u konstatua zyrtarisht se u rritën 10-fish kalimet e pronësisë së makinave të përdorura në Shqipëri, pas anulimit të ligjit, që kontante një taksë për shitësin. Ligji i mëparshëm solli absurdin, e përhapur gjerësisht, që pronarët e makinave, kur i shisnin, nuk e noteriznin kalimin e pronësisë dhe vazhdonin të mbeteshin zyrtarisht pronarë, që të mos paguanin taksën. Kur ky detyrim fiskal u shfuqizua, kalimet e pronësisë ishin dhjetë herë më të

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Qeveria shqiptare merr mbarsht edhe një "reformë" tjetër, atë të taksës vjetore të automjeteve, të cilën, dy vjet e gjysmë më parë, e sollë në fuqi, duke ndryshuar sistemin e taksave nacionale e vendore. Kryeministri Berisha, gjatë mbledhjes së djeshme të Këshillit të Ministrave, ka udhëzuar ministrin e Punëve Publike dhe Transportit që, në bashkëpunim me ministrin e Financave, të përgatisë aktin ligjor për përgjysmimin e taksës për makinat e përdorura. Ky, tha kryeministri, është shqetësim i shprehur nga shumë qytetarë dhe, njëkohësisht, i jep zgjidhje një padrejtësie, që penalizon ata shqiptarë, që nuk kanë mundësinë e pasjes së një makine të re.

Me këtë deklaratë, ai hedh poshtë gjithë atë mbrojtje që

Vendimi

Hyn në fuqi harta e re e vlerës së tokës

Pas miratimit, në një nga mbledhjet e mëparshme të Këshillit të Ministrave, të hartës së re të vlerës së pronës, sipas llojit të pasurisë së paluajtshme, për secilin qark të Republikës së Shqipërisë, këto vlera kanë hyrë në fuqi, duke qenë se afati për këtë ishte publikimi në Fletoren Zyrtare, që ndodhi



dje. Vlerat në këtë hartë janë përcaktuar për çdo bashki e komunë të Republikës dhe janë shoqëruar me harta që i janë bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave, duke qenë pjesë përbërëse e tij.

Harta e plotë mund të gjendet e publikuar sot në sajtin www.shqiptarja.com.

djegim D2. Ne i tejkalojmë edhe normat europiane, kemi një mani të vrapojnë e të vendosim objektiva që BE do t'i arrijë pas 10 vitesh! Ndalimi i D2 është një vendim shumë i mirë, por nuk mund të penalizojmë qytetarët, sepse del që ai që ka, ndihmohet dhe ai që nuk ka, ndëshkohet. Kjo nuk mund të pranohet", deklaroi Berisha.

Ndërkohë, kur është miratuar taksë në fuqi, po i njëjti kryeministër e ka cilësuar si një "akt të shkëlqyer" edhe atë, që tani po e hedh poshtë.

Ditët e fundit, vetë Berisha është angazhuar në një "garë" me kohën për të ndryshuar sa më shumë që mundet në sistemin e taksave, duke filluar nga TVSH-ja për sektorë të ndryshëm, e deri te tatimi mbi të ardhurat personale apo heqja e pagave të referencës. Opozita e akuzon se është kujtuar pikërisht në prag të zgjedhjeve për të marrë mbarsht sistemin fiskal që ngrii në vite, duke miratuar edhe shumë objektiva të bëra publike të Partisë Socialiste.

Këto vlera do të përdoren në të gjitha rastet e shitjeve apo blerjeve, si çmime referencë, në bazë të të cilave do të taksohet shitësi me 10 për qind mbi fitimin e realizuar. Vihet re se nga harta e kaluar ka rritje të vlerave për të gjitha zonat gjeografike e vendit, në bashki e komuna.



Topi-Berishës: Fyles jo karshillëk. Mustafaj: BE, objektiv i FRD

Fryma e Re Demokratike mbajti dje tryezën për marrëdhëniet me jashtë, integrimin evropian dhe emigracionin. Kryetari, Bamir Topi shprehu shqetësimin që kanë qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë në çështjet e integritimit. "Program ynë jep qasjen politike dhe ka predispozitën që FRD të votojë në Parlament çdo ligj në funksion të integritimit evropian. Në çdo koalicion të mundshëm

paszgjedhor, FRD do të ketë parakusht frymën e moderuar dhe integruese në politikë," tha Topi. Kryetari i FRD-së akuzoi kryeministrin për mungesën e respektit në marrëdhëniet me BE kur tha: "kur Komisioneri i BE vjen në Tiranë dhe i bëhet karshillëk, këtu nëse nuk takon kreun, zëre se nuk ke bërë asgjë". Ndërsa ish Ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj, theksoi se për FRD si parti e re dhe me vizion të qartë, integrimi

është një objektiv i panegociueshëm dhe ajo duhet të japë garanci për respektimin e praktikave për integrimin. Mustafaj tha se në Shqipëri nuk ka parti me program anti-integrim, por forcat politike zbatojnë praktika që pengojnë integrimin. Në tryezë folën edhe drejtori i Qendrës për Demokratizimin e Institucioneve, Ilir Alia dhe drejtori i Lëvizjes Evropiane në Shqipëri Gledis Gjipali.

Ish-ministrja dhe deputete e PS, Dade: Paralajmërim për plakushin e politikës Berisha PS-PD: Fyle, mesazhi jo për ne

Mesazhet e Komisionerit për Zgjerimin në KE interpretohen në mënyra të ndryshme nga politika shqiptare. Ish-ministri, deputet i PD Shehu: Presion Ramës të mos bojkotojë

Lajmi

Dy ish-ministrat e Jashtëm shqiptarë, përkatësisht deputetja e PS Arta Dade dhe deputeti i PD Tritan Shehu e komentojnë në mënyra të ndryshme mesazhin e komisionerit të BE, Fyle. Ata vlerësojnë se mesazhi i tij ishte për liderin e kampit kundërshtar.

■■■■ TIRANE

JAKIN MARENA



Arta Dade

Fyle

"Serdhëm në Shqipëri për t'u bërë pjesë e një fushate zgjedhore. Ne do respektojmë zgjedhjen që do bëjmë shqiptarët. Duhet zgjedhje me standarde të larta pa hapësira për kontestime. Unë shpresoj që politikanët të respektojnë rezultatet e zgjedhjeve parlamentare".

po çënohet pavarësia e medias, sulmet ndaj Top Channel rrethimi me polici për ti zhvendosur nga mjediset e punës është tregues i mentalitetit që 'kush nuk më mbështet mua është kundër meje dhe duhet asgjësuar'.

Tritan Shehu, ish-ministër i Jashtëm, deputet i PD:

Padyshim që qeveria e PD ka obligimin më madhor, që zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit të jenë brenda standardeve, dhe do të jenë brenda standardeve, ashtu sikurse ishin zgjedhjet e kaluara. Fitorja e sigurtë bazohet pikërisht mbi këtë princip. Pra ne jemi krejtësisht në sinkron me të gjithë partnerët ndërkombëtarë për këtë çështje. Problemi është zoti Rama, i cili e në mënyrë të vazhdueshme ka kontestuar rezultatit e zgjedhjeve, sepse ai nuk do që ta pranojë humbjen. Unë mendoj se duhet aplikuar gjithë presioni i mundshëm mbi zotin Rama, që të pranojë rezultatit e 23 qershorit, i cili do të jetë një rezultat për gjykimin tim, që do të jetë humbja e tij. Këtu është problemi.

Zyrtarët e lartë evropianë, Fyle dhe



Tritan Shehu

Kukan kërkuan zgjedhje të pakontestueshme, ndryshe bllokohet integrimi....?

Arta Dade: Komisioneri Fyle ka deklaruar pa asnjë ekuivok që zgjedhjet e vitit 2009 të cilat krijuan situatën politike të mëvonshme nuk duhet të përdëriten më. Ato ishin zgjedhje të kontestuara edhe pse Parlamenti Evropian kaloi një rezolutë për domosdoshmërinë e ngjites së Komisionit hetimor parlamentar për të hetuar këto zgjedhje, kjo nuk ndodhi. Pra gjithë deklaratimet e komisionerit Fyle janë parathenie e faktit që BE mbetet i angazhuar për të monitoruar përgatitjet për zgjedhje, procesin e votimit ditën e zgjedhjeve dhe administrimin e këtij procesi. Ai dekurajon çdo përpjekje për të manipuluar zgjedhje dhe padyshim që mazhoranca që është direkt përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve duhet të përbushë të gjitha detyrimet konform ligjit e të respektojë çdo angazhim që ka marrë jo vetëm ndaj shqiptarëve por dhe ndaj partnerëve ndërkombëtarë që na asistojnë gjatë proceseve integruese.

Tritan Shehu: Qeveria dhe zoti Berisha kanë kërkuar që të ketë një prezencë sa më të madhe të vëzhguesve të huaj, pikërisht për të qenë dëshmitarë të cilësive së lartë të zgjedhjeve nga njëra anë, dhe padyshim për të dëshmuar dhe fitoren tonë e cila është e pashmangshme. Unë them që ky është vullneti i plotë dhe i palekundur i një detyrimi të Berisha. Problemi ka qenë kontestimi dhe problemet që ka krijuar Rama në këto vite, siç janë bojkotet, veprimtaritë e dhunshme ndaj institucioneve që ai ka marrë, siç është moslejimi i miratimit të tre ligjeve tashmë në fund, që kanë bërë që të bllokohet marrja e statusit të vendit kandidat të Shqipërisë. Pra i takon elektoratit shqiptar që me votën e tij të dënojë dhe këto veprime krejtësisht ndesh me interesat e vendit dhe kombëtare, të zotit Rama. Dhe elektorati shqiptar padyshim që di t'ia japë këtë përgjigje. Pra unë mendoj se kjo do të jetë zgjidhja e problemeve dhe pengesave në rrugën e integritimit.

Për gazetën "Shqiptarja.com" ish-ministrja e Jashtëm, njëherësh nënkryetare e komisionit të Jashtëm Parlamentar, deputetja e PS Arta Dade dhe ish-ministri i Jashtëm, aktualisht deputet i PD Tritan Shehu kanë dhënë interpretime të ndryshme në lidhje me mesazhet e komisionerit Stefan Fyle për politikën. Nëse Dade thotë se mesazhi i Fyles kishte të bënte me qeverinë dhe kryeministrin Berisha që janë njerëzit që duhet të organizojnë zgjedhjet të lira dhe të ndershme në vend që ti vjedhin ato, deputeti i PD Shehu thotë se mesazhet janë një presion ndaj Ramës në mënyrë që të heqë dorë njëherë e mirë nga bojkoti, pasi parandaj se do të humbë zgjedhjet e 23 qershorit. Njëherësh të dy ligjëvënësit e Kuvendit të Shqipërisë, teksa janë shprehur për zgjedhje të lira dhe të ndershme kanë deklaruar dëshirën për një numër sa më të madh monitoruesish ndërkombëtarë për të garantuar standarde të larta evropiane të këtij ballafaqimi më 23 qershor.

Mesazhi i komisionerit për Zgjerimin në Komisionin Evropian Stefan Fyle për politikën shqiptare ishte që të aplikojnë dialogun për për të arritur integrimin në BE. Komentit juaj?

Arta Dade, ish-ministre e Jashtëm, nënkryetare e komisionit të jashtëm në Kuvend, deputete e PS:

Komisioneri Fyle në vizitën e fundit në Tiranë, i pati mesazhet e qarta lidhur me axhendën evropiane të Shqipërisë. Nuk ka asnjë mëdyshje që dy muaj përpara zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare vëmendja kryesore është përqëndruar tek fakti që Shqipëria duhet të mbajë zgjedhje të lira, demokratike dhe të ndershme. Madje kësaj domosdoshmërie komisioneri Fyle i kushtoi dhe vizitën e tij të parafundit në Tiranë. Pra dje ka ripërsëritur të njëjtin mesazh si dhe në kuadrin e vizionit që në BE integrohet gjithë shoqëria shqiptare dhe jo vetëm klasa politike apo mazhoranca që qeverisin vendin. Ai ka dhënë mesazhe dhe për shoqërinë civile, dhe për rolin në mbajtjen e zgjedhjeve demokratike dhe të ndershme, si një ndër kushtet e avancimit të axhendës evropiane. Unë e gjykoj që veprimtaria me aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare është e mirëpritur, kjo nuk përjashton dhe mesazhet që indirekt i përsëriten plakut të politikës. Edhe për faktin që të pranishëm duhej të kishin qenë përfaqësues nga të dy krahet kryesore të

politikës. Gjithashtu komisioneri Fyle tërhoqi vëmendjen se përveç zgjedhjeve të ndershme e demokratike, Shqipërisë do i duhet të përbushë dhe standarde të tjera që rezultojnë të papërbushura, duke iu referuar 12 pikave të opinionit të Komisionit Evropian, që nga viti 2010. Mjaft shqetësues është fakti që s'ka rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit përkundrazi, në Shqipëri po thellohet korrupsioni dhe në privatizimet e fundit të sektorit strategjik, duke përfshirë Parlamentin në këtë aventurë të rrezikshme. Shqetësues është fakti që

REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

NJOFTIM

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive kujton të gjithë të zgjedhurit dhe nëpunësit publikë që 31 Marsi i vitit 2013 është afati i fundit për deklarimin e interesave private periodike vjetore për vitin 2012.

Në formularin e ri të deklarimit, krahas ndryshimeve (shtesave dhe pakësimeve) të interesave private, duhen plotësuar dhe shpenzimet mbi 500.000 lekë për arredim, shërbim shëndetësor, arsimin dhe pushime, të realizuara gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2012, si dhe duhen bashkëlidhur dokumentat justifikues për pasuritë, të ardhurat dhe detyrimet (sipas ndryshimeve në ligjin e deklarimit të pasurive, tetor 2012).

Formulari i ri i deklarimit të interesave private mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e ILDKP www.hidaa.gov.al.

Ju rikujtojmë që çdo tejkalim afati në dorëzimin e formularit të deklarimit të interesave private dënohet me gjobë nga 50.000-100.000 lekë.



Raporti i OSBE:

Gjyqësor joproduktiv, duhen përmirësime

Gjyqë që nuk prodhojnë drejtësi, qytetarë të Gzhgënjyer, sistem drejtësie, i cili ka nevojë për reformime dhe plot 58 rekomandime, vijnë nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e cila me raportin "Drejt Drejtësisë", i kërkon aktorëve shqiptarë të bëhen të përgjegjshëm dhe të krijojnë një sistem eficient. Sipas raportit të bërë public dje, gjatë një aktiviteti të përbashkët me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, 47 për

qind e seancave gjyqësore në gjykimet civile, janë joproduktive dhe krijojnë problem me drejtësinë që u jepet qytetarëve. Ky konstatim vjen nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ku me anë të raportit "drejt drejtësisë" nxjerr në pah, se gjysma e seancave gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bëhen pa argument. Sipas ambasadorit Eollfarth, reformat e bëra në drejtësi, nuk nënkuptojnë

mbarimin e punës, por ka ende vend që të kontribuohet në këtë fushë. Të pranishëm në takim ishin dhe ministri i Drejtësisë Eduard Halimi si dhe nënkryetari i KLD-së Elvis Cefa, të cilët veç arritjeve të deritanishme në sistemin e drejtësisë pranuan, se 58 rekomandimet e dala nga ky raport, do të shërbejnë që aktorët e trupës gjyqësore të bëhen më të përgjegjshëm në dhënien e drejtësisë.

DISA NGA REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

- Rekomandim për mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës
- Rekomandim për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit nr. 10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjëseve të Policisë së Shtetit, të Gardës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të SHISH e të Policisë së Burgjeve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës, duke i dhënë fuqi prapavepruese e shtrirë efektet e zbatimit të tij që nga data 01 Janar 1991.
- Rekomandim, në zbatim të ligjit nr.9389, datë 4.05.2005, "Për krijimin dhe funksionimin e këshillit kordinues në luftë kundër fenomenit të gjakmarrjes.
- Rekomandim për nxjerrje aktesh nënligjore për të përmbyturit në Shkodër.
- Rekomandim për hartimin e Projektligjit "Për kthimin e kompensimin e pronës së luajtshme në referim me nenin 5 të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin e kompesimin e pronave".
- Rekomandim që në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e rregullave e të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit financiar ish pronarëve, të gjejë zbatim të saktë dhe të plotë Vendimi Unifikues nr.6, datë 24.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Rekomandim për ndryshimin e Udhëzimit nr.02, 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit"
- Rekomandim për hartimin e akteve nënligjore. "Për ushtrimin e nismës për plotësimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142 për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtrisë së FA, të Punonjëseve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjëseve të SHKB në Republikën e Shqipërisë".
- Rekomandim, "Për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr.9128 datë 29.07.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve futurues në pension", i ndryshuar. Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Presidentit. Rekomandim, amendim ligjor "Për ndryshim në Ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".
- Rekomandim, akt nënligjor, "Për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit Rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual.
- Rekomandim, akt nënligjor, "Për ndryshimin e Vendimit të qeverisë nr.787/2005 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike".
- Rekomandim, për ndryshimin e Ligjit "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane"
- Rekomandim, ndryshim legjislativ për përfshirjen e veprave penale me natyrë politike të ligjit 1138 të vitit 1950, në nenin 5 të ligjit nr.9831, dt.12.11.2007 "Për dëshmipërlimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist".
- Rekomandim, akt nënligjor, për marrjen e masave për përgatitjen dhe miratimin e VKM për dhënien e dëshmipërlimit për periudhën e internimit.
- 8. Rekomandim, ndryshim ligjor, për një shtesë në ligjin për të drejtat e fëmijëve.
- Rekomandim, për ndryshimin dhe përmirësimin e nenit 450 të Kodit të procedurës Penale.
- Rekomandim "Për ngritjen e shkollës së riedukimit për personat, që nuk kanë përgjegjësi ligjore.
- Kundër aktit normativ "Për lirin e banesave të ish-pronarëve"
- Kundër ndryshimeve në "Për statusin e të verbërit".
- Kundër ndryshimeve në ligjin "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tretraplegjik".

Raporti i Avokatit të Popullit, kritika qeverisë, drejtësisë

"Problem pensionet përmbytjet e pronat"

Totozani: Ish-të përndjekurit duan zgjidhje

Lajmi

Avokati i Popullit Igli Totozani ka dërguar raportin vjetor në Kuvend duke evidentuar si problem më shqetësues zgjidhjen e çështjes së pronave, ish-të përndjekurve, përmbytjet në Shkodër, sjelljes së policisë, prokurorisë, gjykatave, romët e pensionet.

TIRANE
JAKIN MARENA

Avokati i Popullit Igli Totozani ka dorëzuar në Kuvend një raport prej më se 350 faqesh ku në mënyrë të detajuar ka paraqitur të gjitha shqetësimet duke filluar nga sjellja e policisë me të ndaluarit, evitimin e torturës e deri tek kujdesi për romët. Teksa ka evidentuar procedurat e stërgjatura për sigurimin suplementar për ish-ushtarakët, përfshirë dhe ato të policisë dhe të SHISH, Totozani kërkon implementimin e shpejtë të ligjit të përmirësuar për përfshirjen e kësaj kategorie në sigurimin suplementar. Nga ana tjetër një ndër problemet më të rëndësishme që ka ngritur në raportin e tij vjetor Avokati i Popullit ka qenë dhe dëshmipërlimi i ish-të përndjekurve dhe ish-të burgosurve politikë sipas ligjit, duke nënvizuar njëherësh se është shumë e rëndësishme që problemet që ata kanë të zgjidhen me shumë qetësi, dhe jo përmes elementëve të tjerë duke përdorur dhe forcën. Një ndër çështjet më të rëndësishme që ka evidentuar Totozani në raportin e tij vjetor ka qenë zgjidhja e problemit të pronave, problem i cili ka 23 vite që zvarritet, ndërkohë që ai ka rekomanduar që të marrin fund zvarritjet nëpër hipoteka dhe në pushtetin vendor. Nga anekset dhe kontaktet direkte të stafit me individët ankesues, konstatohet se në shumë raste nuk u hapen dyert e organeve të administratës publike qendrore, apo vendore për të



Igli Totozani

dërguar kërkesat ose anekset që kanë, si dhe për t'u siguruar informacionin e s'qarimet e duhura. Problematike mbeten e anekset e individëve lidhur me mospërfitimim e dëshmipërlimit për shtëpitë e përmbytura në qarkun e Shkodrës në fund të vitit 2010. Avokati i Popullit ka rekomanduar konkretisht alokimin e fondeve nga KESH në një depozitë të veçantë në Qeverisë. Mungesa e fondeve nga KESH nuk mund të jetë arsye, apo shkak ligjor për zvarritjen e dhënies së dëshmipërlimit të parashikuar në vendimin e qeverisë. Duhet marrë në konsideratë pretendimet e subjekteve tëregëtare,

fermerëve si dhe procedurat e vlerësimit të dëmeve dhe klasifikimit të tyre jashtë listës së përfutuesve. Nga ana tjetër Totozani shprehet se është shumë e rëndësishme që të përmirësohen kushtet për burgje. Njëherësh Totozani është shprehur për masat të rrepta kundër gjakmarrjes, për të drejtat e komunitetit rom dhe shumë shqetësues për të ka qenë dhe kujdesi ndaj të sëmurëve mendorë, pasi sipas tij ka mbipopullim të spitaleve.

Integrimi

Malaj me gjimnazistët e "Qemal Stafës"



Një ditë më parë në bashkëpunim me Parlamentin Rinor Shqiptar, nxënësit e gjimnazit Qemal Stafa në Tiranë, kanë organizuar një konkurs me temë "Si e sheh rinia shqiptare vendin e saj përballë sfidave të integrimit europian". Nga të rinjtë, kjo shihet si një mundësi ku ata mund të ngrenë zërin dhe paraqisin idetë e tyre. I ftuar në këtë aktivitet ishte edhe deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, njëkohësisht edhe anëtar idelegacionit parlamentar të vendit tonë në PE, Arben Malaj. Para auditorit, ai si një lektor i njohur në Universitetet shqiptare e ndërkombëtare për integrimin, përsëriti iniciativën e këtyre të rinjve, si inspirim për të ardhmen e të rinjve dhe promovimin e vlerave më të mira evropiane dhe demokratike.

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjeçare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabinetit "SALAJ" ju vijen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurit, përballë Taiwan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



PS kundër raportit të KKRT: Ka dështuar si institucion

Kryetarja e Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, Endira Bushati gjatë paraqitjes së raportit vjetor për 2012 të këtij institucioni në Komisionin e Medias, deklaroi se me drejtorinë e Tatimeve nuk ka patur bashkëpunim përse i përket vjeljes së gjobave të vendosura. KKRT u mbrojti me faktin e vendeve vakante në Këshill, për të shprehur se

jo gjithëka është në dorën e tyre lidhur me dështimet. Sipas KKRT problem për të qëndronte edhe përballja me rojet private, që nuk lejojnë monitorimin e mediave. Ndër të tjera, Bushati tha se është rritur pirateria televizive, mospagesa e detyrimeve vjetore ndaj KKRT-së dhe problemet e tjera me monitorimin e gjithë operatorëve. Edhe

kryetarja e Komisionit të Medias Valentina Leskaj, tha se i gjithë raporti dëshmon për një dështim të vazhdueshëm të KKRT-së sa i përket njohshmërisë politike. "Është dështuar me çështjen e reklamave, me privatësinë, me të drejtat e njeriut dhe fëmijëve dhe gjithë këto dështime ju nuk mund t'ia faturoni dy argumentave që ju thatë këtu: ligjit dhe vakumësisë", tha ajo.

Votohen sot dekretet e Nishanit, LSI: Të votohet Artan Hoxha

Presidenca: Dekretet e reja sipas ligjit

Kuvendi nuk votoi propozimet e Bamir Topit

Lajmi

Dekretet e presidentit Nishani lidhur me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë do të hidhen sot në votim. Pritet qëndrimi i palëve pasi PS bojkotoi diskutimin e tyre në Komisionin e Ligjeve.

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Parlamenti pritë që të hedhë sot për votim dekretet e propozuara nga presidenti i vendit, Bujar Nishani për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Por shqetësimi, jo vetëm i opozitës, por dhe aleatëve të PD është çështja e mosvotimit të dekretëve të mëparshme që janë propozuar nga ish-presidenti Bamir Topi. Institucioni i Presidencës, i kontaktuar nga gazeta nëpërmjet zëdhënësës për shtyp, theksojnë se propozimi i dekretëve të reja për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese si dhe një anëtar për Gjykatën e Lartë nuk është aspak në shkelje të ligjit. "Dekretimi nga Presidenti i Republikës i 2 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese Gani Dizdari e Besnik Imeraj dhe anëtarit të Gjykatës së Lartë Xhezair Zaganjori është bërë sipas kritereve dhe kërkesave që parashikon ligji", shprehet zëdhënësja e Presidencës, Irma Toptani. 2 ditë më parë Presidenti, Bujar Nishani i kërkoi Parlamentit të votojë dekretin e Bamir Topit, ish-anëtarin e Gjykatës së Lartë, Artan Hoxha, për në Gjykatën Kushtetuese. Ai u shpreh se vendi i tretë vakant nuk ka një emër nga ana e tij për shkak se paraardhësi Topi ka çuar emrin e Hoxhës në Parlament.

PËRPLASJA

Përgjegjësia që dekretet e Nishanit janë të mbivendosura mbi ato të ish-presidentit Topi, bie mbi Kuvendin që nuk i kaluar ato për shqyrtim dhe votim. Përplasja Presidencë-Kuvend daton që në qershor 2011, ku ish-presidenti Topi, i dërgoi Parlamentit emrat e Artan Hoxhës, Edlira Jorgaqit, Adrian Lekës dhe Fatmir Hoxhës për në Gjykatën Kushtetuese. PD-ja miratoi vetëm kandidaturën e Fatmir Hoxhës dhe ia ktheu mbrap-



Trë dekretet e Nishanit, Zaganjori, Imeraj dhe Dizdari

sht Topit 3 emrat e tjerë. Në këtë mënyrë, Xhezair Zaganjori dhe Admir Thana qëndruan në detyrë edhe 3 vite, ndërsa Petrit Ploçit, të cilit i kishte mbaruar mandati në vitin 2010, dha dorëheqjen një vit më parë. Pas dorëheqjes së Ploçit, Topi e ridërgoi dekretin e Artan Hoxhës për t'u votuar, por ai nuk u mor

në shqyrtim nga shumica. Por ndërkohë që në rregulloren e Kuvendit thuhet qartë se futen automatikisht dekretet e Presidentit të Republikës. Deputetët shprehën se kjo është detyrë e Konferencës së Kryetarëve për t'i futur në rendin e diskutimeve në komisionet e përhershme parlamentare dhe më pas miratimit të tyre

ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT DHE TË KOMISIONEVE TË TIJ

Neni 26/ pika 7

Në programin e punës së Kuvendit futen automatikisht dekretet e Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligjesh, emërime, për të cilat kërkohet pëlqimi i Kuvendit, projektligje financiare ose ndryshimi i Buxhetit të Shtetit, shqyrtimi i akteve normative me fuqinë e ligjit, propozimet për emërim dhe shkarkim titullarësh të organeve që zgjidhen nga Kuvendi, mocionet e kërkuara, projektligjet ose projektvendimet e mbartuara nga programi paraardhës, si dhe çështjet që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme.

në seancë plenare.

LSI: VOTOJMË TË PAVARUR

Nënkryetari i LSI, Petrit Vasili lidhur me dekretet e propozuara nga Nishani për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartës, theksoi se më parë Kuvendi duhet të votojë kandidaturën e propozuar nga Bamir Topi të Artan Hoxhës si anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Qëndrimi LSI mbi emrat e tjerë do të vendoset sot në mbledhjen e grupit që do të mbahet

para fillimit të seancës plenare. "Lidhur me mosshqyrtimin e dekretit për gjykatësin Artan Hoxha, ne e vlerësojmë si një anomalitet, sepse çdo dekret i Presidentit ka detyrimin ligjor që të merret në shqyrtim nga Parlamenti dhe ky i fundit mund të shprehet pro apo kundër sipas gjykimit të tij", u shpreh Vasili. Ndërkohë që sipas Nasip Naços, LSI në të shumtën e rasteve i ka votuar dekretet e presidentit, kjo në mënyrë të pavarur dhe jo të ndikuar nga grupi.

Ligji



Gjoba progresive për ndërtimet informale

Rritja progresive e gjobave për ligjin për planifikimin e territorit synon frenimin e ndërtimeve pa leje dhe pa kritere urbanistike. Ky ishte argumenti i të djathtëve në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. "Brenda natës, gjithë ajo punë 4 mijë orë është kthyer me kokë poshtë dhe tani na këni sjellë një gjobë progresive ashtu siç duhet të ishte normalisht, që, kush shkel më pak paguan më pak dhe kush shkel më shumë paguan më shumë", u shpreh deputeti i opozitës, Artan Gaçi. Sipas këtij projektligji, do të aplikohet gjobë 10 % e vlerës së objektit për investime 5 milionë lekë, 20 % për investime nga 5-10 milionë lekë dhe 30 % për investime mbi 10 milionë lekë.

Përplasja

Berisha-Rama, akuza për infermieret

Kryeministri: Punonjëset jo shtëpi publike. Kryesocialisti: Hajde në debat. Tavo: Strategji kombëtare për shëndetësinë

■ ■ ■ TIRANE

Kreu i qeverisë iu kundërpërgjigj dje akuzave të lëshuara pak ditë më parë nga kryesocialisti Rama për mbrojtjen e pacientëve nga infermieret. Ai kërkoi që Rama të kërkojë falje publike. "I kërkoi zotit Rama publikisht të tërheqë fjalën shumë pa mend që ka thënë për infermieret. Ato janë vajza, gra, nëna, motra dhe nuk kisha dëgjuar kurrë ndonjëherë, nëse të duken spitalet shtëpi publike. Punonjësit janë pasuri kombëtare, shtetërore, nuk janë reparte partiake, klube militantësh", tha kreu



i qeverisë. Ndërkohë që në reagimin e tij, Rama i kërkoi kryeministrit një debat publik për shëndetësinë. "Pse mos bëjmë një debat publik për shëndetësinë, që të merret vesh se kush duhet t'u kërkojë ndjesë jo vetëm infermiereve po të vdekurve e të gjallëve? Po nëse ia mban zemra debatit në t'i zgjedhë vetë vendin formatin gazetarët ditën, orën dhe le t'i shohim aty pastaj sukseset në shëndetësi! Një kardiolog në pushtet që rrethoi shëndetësinë dhe një kryeministër që taksom në shumë infermieret se veten duhet të ikë me vrap e të fshihet, Turp!", shkruan Rama në Facebook. Ndërkohë dje në

një emision televiziv në Ora Neës, Ministri i Shëndetësisë, Vangjel Tavo ka deklaruar se: "Politika nuk duhet të përdorë mjekët dhe infermieret për fushatë elektorale. Ata me punën e tyre, mund t'i quajmë heronj të heshtur. Ato që janë thënë për mjekët dhe infermieret nga një kryetar partie janë të papranueshme", është shprehur Tavo. Kreu i Shëndetësisë, i ka ftuar politikanët që të gjejnë guajën e përbashkët përse i përket zhvillimit të sistemit shëndetësor. "Politikanët duhet të ulen në tavolinë dhe të gjithë së bashku të bëjmë një strategji kombëtare për sistemin shëndetësor", ka propozuar Tavo.



Portretet zgjedhor pa autorizim



NGA EDMOND ARIZAJ

Nëse ndokush mund të personifikohet sot fort me qytetin, kjo është Jozefina Topalli. Krenare deri në ekstrem për prejardhjen e saj, nuk lë rast pa e futur Shkodrën mes vetes dhe bashkëbiseduesit, qofshin këta edhe shumë. Herë duket se është qyteti që e mbron Topallin, e jo pak herë Jozefina del si kryekëshqjellare e Rozafatit. Me gjuhën e shkurtër, humorin deri në sarkazëm, qëndron mbi bedenin e Parlamentit përherë syçelë, duke u bërë një mburojë zanore e idhullit të saj, Sali Berishës...

Nuk është shumë e lehtë për kryedeputetën shqiptare. "Zoti i ka fal" sharmin e Zhaklinë Kenedit, por politika e detyron të jetë e hekurt, një Margaret Theçer. E ndonjëherë edhe "gjermane". Por ashpërsinë e sallës së Kuvendit, ajo përpigjet ta "neutralizojë" kur me xhinsa e mes vazjave të reja, nuk heziton të këndojë e të kërcëjë në bulevardin e madh. Nuk e ka problem të ndërrojë dy lekure brenda ditës. Nga ashpërsia deri në arrogancë, teksa mbron "të sajët" në Kuvend, në përlulesinë ngjashmërisht "nënë Terezë" (një temë që ajo jo pak herë e sjell mes shqiptarëve) tek përqafon nevojtarët, apo edhe adhurueset. Nga serioziteti I numrit dy të shtetit, në makinën e rëndë e të zezë të kryeparlamentares, në xhiron me motora mes shkretëtirave arabe.

Nëse Jozefinës do t'i heqësh atë pjesën "e ashpër", fare mirë mund të dilte një zonjë që mendon vetëm për të drejtat e grave. Në të vjetër përballë 139 deputetëve, nuk mund t'i numërosh as me gishtat e dorës replikat me grat deputete. Por gishtat nuk mjaftojnë për të numëruar aktivitetet pro grave. Mos ndoshta Topalli është një feministe e fshehur? Apo mos vallë e lodhur, së bashku me simotrat e saj majtas e djathtas nga "dhuna burrërore shqiptare" kërkon të ngjallë e të mbrojë me sa mundet femrën?

A ka ndonjë ditë të errët Jozefina Topalli? Ajo është e kujdesshme të mos e tregojë në publik. Është e vetëdijshme se kamerat, të dashura apo hidhnake e ndjekin në çdo moment,



SHKODRA Tre muaj para zgjedhjeve të këtij viti, Topalli nuk e ka lënë kohën t'i shkojë dëm, e as Shkodrën t'i rrënohet në pikën pa kthim. Ndoshta nuk është "Shkodër locja", por gjithsesi mund të flitet për një qytet që gjallon, jeton, dhe ecën... edhe me biçikleta.

NË FOTO: Sali Berisha dhe Jozefina Topalli

Kështjella e Jozefinës

Edhe kur qesh menjëherë pas Berishës. Edhe kur takon Papën e ri pas Berishës. Edhe kur mbron çdo propozim të Berishës, qoftë ky për hidrocentrale, apo për arra. A mund të jetë ajo "një Berishë"?!?

ndaj në çdo moment ajo është e syçelë. Por duket se dita e saj më e errët ka të bëjë pikërisht me zgjedhjet. Atëherë kur Partia Socialiste, kundërshtarët, "guxuan" të hynin në kështjellën e saj, Rozafatin. Nuk ia dolën, por jo pa lënë shenja. Ishte ndoshta një shkundje për Topallin se shkodranët e saj, nuk mund të mbaheshin më vetëm me kujtime, e as të ushqeheshin me dosje ish-komunistësh, e as të përkujtonin çdo ditë diktaturën duke ecur në rrugët shkatarrake të mbetura prej asaj kohe...

Tre muaj para zgjedhjeve të këtij viti, Topalli nuk e ka lënë kohën t'i shkojë dëm, e as Shkodrën t'i rrënohet në pikën pa kthim. Ndoshta nuk është "Shkodër locja", por gjithsesi mund të flitet për një qytet që gjallon, jeton, dhe ecën... edhe me biçikleta. E ajo, në 23 qershor do të kërkojë të jetë sërish "e përkëdhelura" e qarqeve të Shqipërisë për Partinë Demokratike. Ndoshta nuk do të jetë e lehtë. I duhet të përballojë presionin e një tetë vjeçari qeverisës, që nuk ka shkuar fllorë për shqiptarët, madje edhe për shkodranët, i duhet të përballojë edhe rëndësinë e pamundësisë për të integruar të gjithë të persekutuuarit e Shkodrës dhe pasardhësit të tyre, dhe që janë shumë. Pa i duhet

të ruajë balancat mes atyre që duan vetëm Jozefinën, por që po u zbehet dashuria për Berishën, apo e kundërta, e më e keqja fare, atyre që s'kanë më dashuri. E mbi të gjitha do t'i duhet t'i përballojë sulmet e një partie prej tetë vitesh në opozitë. Që mund të kenë të njëjtin forcë me PD e 2005-ës. E, Topalli sigurisht që nuk do të mjaftohet, se Shkodra është Shkodër. Edhe Kavaja ishte...

"Po mër", thotë Topalli me atë shkodranishten e këndshme, ku "ë" herë merr nga "e"-ja, e herë merr nga "o"-ja. Është e sigurtë. Edhe në hap, kur ecën krah Berishës. Edhe kur ngre dy gishtat më lartë se Berisha. Edhe kur qesh menjëherë pas Berishës. Edhe kur takon Papën e ri pas Berishës. Edhe kur mbron çdo propozim të Berishës, qoftë ky për hidrocentrale, apo për arra. A mund të jetë ajo "një Berishë"?! Të paktë janë ata që mund të guxojnë ta thejnë këtë perceptim të kësaj kohe, apo edhe të ardhmes. Mund të guxojnë vetëm duke pasur pikërisht dorën e Sali Berishës mbi shpatulla, por Topalli është aty. Dhe është shumë e fuqishme. Aq e fuqishme, sa qoftë edhe duke buzëqeshur mund t'ua heqë të dyja duart e Berishës nga shpatulla dhe t'i lërë për-

ballë akullit të qëndrestarëve... Jozefina pret... Tani është e preokupuar "të masakrojë" socialistët dhe Ramën për tre ligjet. Një përgjegjësi që ajo e merr pa mëdyshe, ku herë shfrytëzon fuqinë e butonit të mikrofonave, e herë mundësinë që i jep e drejta për të mbyllur seancën... duke thënë ajo fjalën e fundit, pikërisht atë që mbetet në mendjen e shqiptarëve të uritur për komente...

Ndoshta do të jetë sërish edhe katër vite të tjera aty... ministritë mund t'ia heqin kënaqësinë e "Jozefinës kryetare", edhe kur shqiptohet ironikisht nga Taulant Balla. Diku tjetër, do të jetë thjesht "zonja Topalli", një nga 14 të tjerët... Apo ndoshta dhe s'do të jetë më, së bashku me gjithë epokën të të vjeçare, duke u zëvendësuar në rastin më të mirë nga një prej socialistëve të sallës... Edhe Theçer pas 11 vjetësh nuk ishte më.

Gjithsesi, pas 23 qershori i këtij viti do të japë përgjigje për shumë pikëpyetje. Mes tyre edhe për Jozefina Topallin. Pa pikëpyetje është vetëm një gjë: Edhe këtë rradhë ajo do të jetë zonja e parë e Shkodrës. E kështjellës së saj...



NË FOTO: Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli

Arvizu, aktivitete-takime

SHBA, presion i fortë për 23 qershorin

Ambasadori Aleksandër A. Arvizu Asot do prezantojë mbështetjen e për Zgjedhjet Parlamentare 2013 në Shqipëri. Programi i Grantëve të Vogla të Komisionit për Demokraci e Ambasadës Amerikane, mbështet përpjekjet e shoqërisë civile civile që adresojnë aspektet më të rëndësishme të procesit zgjedhor në Shqipëri, të cilat përfshijnë: nisma ndërgjegjësimit ndaj votuesve; të drejtat dhe përfaqësja zgjedhore për personat me aftësi të kufizuar, komuniteti Romë, LGBT-të,

dhe grupeve të tjera të pafavorizuara ose pakicave; pjesëmarrjen e grave si votuese dhe kandidatë; pjesëmarrjen e të rinjve votues dhe atyre që votojnë për herë të parë; forume qytetare; fushata të medias sociale. USAID/Albania do sigurojë ndihmë teknike për KQZ në planifikimin e vlerësimin përgjatë dhe pas zgjedhjeve. Si dhe do ofrojë mbështetje për Koalicionin e Vëzhguese Vendorë, që do vëzhgojë gjithë procesin zgjedhor dhe NDI, që do kryejë punë monitoruese ndërkombëtare. Nis-



ma Act Noë-Albanians Coming Together Noë është duke organizuar tre debate parazgjedhore, më 5 prill, 23 prill dhe 3 maj. Pjesëmarrësit në debate-anëtarë të forumeve rinore nga PD, PS, LSI, FRD e AK, do të mbulojnë temat e arsimit dhe punësimit, shtetit të së drejtës dhe luftës ndaj korrupsionit, ekonomisë dhe anëtarësimit në BE. Ndërsa dje, Arvizu teksa ka marrë pjesë në konferencën e FRESH "Arsimi dhe punësimi rinor", e vuri theksin tek zgjedhjet e lira dhe të ndershme. "Faleminderit FRESH për

ftesën. Mezi po e prisja këtë aktivitet, për të parë se si të rinjtë janë mbledhur bashkë me shoqërinë civile për të hartuar politikat e tyre. Gjatë vizitës së Klinton, e keni ndjekur fjalimin, i kërkoj politikës që zgjedhjet të jenë të lira e të ndershme e të shihen të tilla nga e gjithë bota, në radhë të parë që ju të rinjtë që të keni besim te politika. Zonja Clinton nuk nënkuptoi vetëm zgjedhje për të zgjedhur zgjedhësit, por edhe shtyp të lirë, institucione të pavarura", tha ai.

Skadon afati kërkohet lirimi i babait të deputetit

Skadojnë afatet ligjore ndaj babait të Sdeputetit socialist, Bashkim Tahiri, si dhe dy të arrestuarve të tjerë, të cilët u vunë në pranga nga policia e Tiranës, për "kontrabandë medikamentesh". Avokati i Bashkim Tahirit, Plarent Ndreca, deklaroi dje për "Shqiptarja.com", se "seanca për marrë arresti nuk u zhvillua sot (dje), por ajo çka ka rëndësi tani, është fakti, se Bashkim Tahiri

mbahet jashtë afatit ligjor pa dalë përpara një gjyqtari e në orën 16.00 të së mërkurës, arrestit i ka rënë fuqia". Më tej, Ndreca ka theksuar, se ai mbahet brenda pa vendim gjyqësor, është shkelje e çdo procedure të kodit të procedurës penale, çka tregon për vendime politike". Ndërkohë, Prokuroria e Tiranës ka dërguar dje në gjykatë, kërkesën për Bashkim Tahirin, Dritan Gjizën dhe

nadire Tagën. Burimet nga Prokuroria bëjnë të ditur, se në seancën e nesërme (sot), në kërkesën e prokurorisë për masë arresti, për Tahirin do të kërkohet "detyrim paraqitje", duke kërkuar kështu lirimin e babait të deputetit të PS-së, Saimir Tahiri. Të njëjtat burime pohuan, se e njëjta masë do të kërkohet dhe për Nadire Tagën, ndërsa për Dritan Gjizën, "arrest me burg".

SHBA, ish-zyrtari i Ministrisë së Jashtme u dënua 6 vjet

Almir Rrapo, 1500 euro nga Strasburgut

Qeveria detyrohet ta dëmshpërblejë moralisht

Lajmi

I arrestuari për llogari të SHBA-ve dhe i ekstraduar me procedurë të përsheptuar, paguhet nga Qeveria e Shqipërisë. Këshilli i Ministrave miraroi dje shumën e 1500 euro, që do t'i përfitojë Almir Rrapo, pasi Gjykata e Strasburgut i dha të drejtë atij, për dëm moral.

TIRANE

Një akt i Këshillit të Ministrave, i miratuar dje, ka vendosur ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Strasburgut në favor të ish-punonjësit të ministrisë së Jashtme, Almir Rrapo, të ekstraduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të dënuar për vrasje, por me ulje dënimi për shkak të bashkëpunimit me drejtësinë amerikane. Shuma e akorduar është 1500 euro, që do të jepet për dëmin moral që i është shkaktuar Rrapos nga vendimi i qeverisë shqiptare për të zbatuar marrëveshjen me shtetin amerikan për ekstradim të të kërkuarve. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e kishte marrë vendimin më datë 25.9.2012, për çështjen nr.58555/10 "Rrapo kundër Shqipërisë". Efekti financiar i këtij vendimi do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Shuma e përcaktuar si detyrim, do të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, Almir Rrapo dhe do të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shumën, në datën e kryerjes së pagesës. Pagesa e shumës së depozituar do të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda marsit 2013. Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

Almir Rrapo u arrestua në datën 2 korrik 2010 në ambasadën e SHBA-së, pasi mbi të rëndomin disa akuzat të rënda, siç janë ato për vrasje dhe krim të organizuar. Ai akuzohet, se në bashkëpunim me Bruno dhe



Almir Rrapo në sallën e gjykatës

Saimir Krasniqin, më 17 korrik të vitit 2005, në Kuins të SHBA-ve, kanë ekzekutuar Erion Shehun, rival i tyre në trafikun e drogës. Ish-zyrtari i Ministrisë

së Jashtme, Rrapo, i njohur me nofkën Miri, akuzohet dhe për rrëmbimin e një tjetër rivali në trafikun e drogës, ngjarje e ndodhur në vitin 2005. Në vitin

Pretendimet

Avokati në atë kohë, nuk ngurroi ta quante të parregullt edhe tërësinë e veprimeve institucionale të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjyqësorit, madje ai shkoi më tej duke i quajtur ato si të realizuara në një formë barbare, shkelje të ligjit dhe të drejtave themelore të Rrapos.

2003, banda e vëllezërve Krasniqi rrëmbeu një tjetër person, duke e kërcënuar, se do ta vrisin vetëm pse nuk kishte respektuar një anëtar të bandës. Ndërkaq, më 14 janar të vitit 2006, banda ekzekutoi Erenik Grezden, tekta ky lëvizte me makinën e tij në autostradën Bruklin-Kuins, në Nju Jork. Vrasja ndodhi pasi vëllezërit Krasniqi dyshonin se Grezda i kishte ngritur kurth Bruno

Krasniqit për t'u rrëmbyer nga një grup trafikantësh shqiptarë droge, rivalë të fuqishëm të tyre. Sipas Byrosë Federale të Hetimeve, organizata vepronte në shumë shtete të Amerikës, si Nju Jork, Miçigan dhe Konektikat.

Në fillim të muajit tetor 2010, Gjykata e Tiranës vendosi ekstradimin e Almir Rrapos drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjykata dëgjoi pretendimin e përfaqësuesit të prokurorisë, i cili tha se kërkesa e FBI-së duhet pranuar, pasi është e ligjshme. Ndërkohë, avokati Ardian Visha kërkoi refuzimin e kërkesës së autoriteteve amerikane. "Nëse arrestimi i Rrapos do të ishte i ligjshëm, atëherë ai nuk duhet të bëhej në ambasadë", tha Visha. Sipas avokatit, për një prej veprave penale, për të cilën mund të gjykohej në SHBA, nëse ekstradohet, klienti i tij rrezikon dënimin me vdekje. Almir Rrapo është pënuar

PYETJE PERGJIGJE

Përse u dëmshpërblejë Almir Rrapo?

Qeveria miratoi dje me VKM, shumën e 1500 eurove për t'u paguar Rrapos, në bazë të një vendimi të Gjykatës së Strasburgut, për dëm moral, pasi Rrapo e kishte çuar çështjen atje, në lidhje me mënyrën e arrestimit dhe ekstradimit të tij.

Kur u arrestua Rrapo?

Në atë kohë 27 vjeç, Rrapo u prangos brenda ambienteve të ambasada-së së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, ku kishte kërkuar të pajsei me vizë?

Për çfarë akuzohet?

Ish-zyrtari i Ministrisë së Jashtme kërkoi nga FBI-ja, si pjesë e një bande vrasjesh e trafiku droge në SHBA. Madje, ai akuzohet edhe për rrëmbim e vrasje.

■ **Ku ndodhet tani?** Pas ekstradimit, Rrapo bashkëpunoi me drejtësinë amerikane dhe pasi tregoi krimet e bandës "Krasniqi", u dënua me 6 vjet burg.

për krimet që ka bërë në SHBA, ndërsa ka bashkëpunuar me drejtësinë për të zbardhur krimet e bandës "Krasniqi", ndërsa u dënua me 6 vjet burg.

Vrasja e komisarit

Adem Tahiraj, rrëfohen dëshmitarët

E plagosura nga plumbat e Ilir Xhakjes dhe efektivet e policisë, dëshmojnë ekzekutimin

TIRANE

Në Gjykatën e Krimeve të Rënda u zhvillua dje seanca gjyqësore në ngarkim të Ilir Xhakjes, të akuzuarit për vrasjen e kryekomisarit të policisë Adem Tahiraj, shtatorin e vitit të kaluar. Seanca nisi me pyetjen e dëshmitarëve, disa prej të cilëve, kolegë të kryekomisarit. Një nga dëshmitarët e pyetur dje është Eleni Ndoka, e cila u plagos në derën e shtëpisë. Ajo deklaroi, se nuk i mbante mend fytyrat e personave që ka parë atë natë, madje, nuk kujton shumë detaje. Dëshmitari i dytë ka qënë Dilaver Osmani, Shefi i krimeve në atë kohë, në Komisariatin e Shijakut. Ai tha se atë ditë ka takuar Hoxhën dhe Gosturamin, të veshur civilë dhe që dukeshin të tronditur. "Ditën kur ndodhi vrasja, policia kishte përgatitur një operacion për



Ilir Xhakja

kapjen e personave me precedent penalë, tha ai. Unë urdhërova dërgimin e Hoxhës dhe Gosturamin në Drejtorinë e Policisë". Dëshmitari i tretë ka qënë Arben Basha, Shefi i



Adem Tahiraj

sallës në Policinë e Qarkut të Durrësit. Ai tha, se "ngjarjen e njoftoi shefi i Rendit të Shijakut, Besnik Domi. Ai tha në radio; është vrarë Adem Tahiraj".

Dëshmitari i katërt, inspektori i zonës Haxhi Shehu deklaroi para togave te zeza, se "Gosturani dhe Hoxha nuk jepnin shpjegim për ngjarjen". Dëshmitari i pestë, Besnik Domi, Shefi i patrullës në Shijak, shpjegoi, se "është njoftuar në orën 17:30 nga Fatmir Hoxha, i cili i tha të vinte urgjent në Sukth, pasi kanë vrarë Adem Tahiraj. Më pas, kam njoftuar dhe policinë e Durrësit dhe mora prapë Fatmirin, që më thoshte "hajde urgjent" pa shpjegim tjetër".

Komisari Adem Tahiraj u vra në 13 dhjetor 2012, gjatë një kontrolli të automjeteve për armëmbajtje në Sukth të Durrësit. Për këtë ngjarje u akuzua Ilir Xhakja, i cili ishte i hirë, falë moszbardhjes së një vendimi në Gjykatën e Durrësit nga gjyqtari Neritan Tabaku. Ky i fundit është shkarkuar nga detyra, madje është në proces gjyqësor.



Hodhi foshnjën nga dritarja, babai mbyllet në psikiatri



Gjykata ka vendosur shtrimin e detyruar në psikiatri për babanë, i cili hodhi fëmijën e tij të sapolindur nga dritarja e maternitetit në Tiranë, në korrik të vitit të kaluar. Pas ekspertizës, e cila nxori përfundimet, se Hysen Biba është me probleme psikike, Dhoma Penale e gjykatës së

Tiranës dha këtë vendim. Hysen Biba nga Kukësi, në korrik të vitit 2012, në gjendje nervozizmi, hodhi nga dritarja e maternitetit, foshnjën e tij të sapolindur. Në atë kohë u gjykua, se ai kishte pasur debate me bashkëshorten e tij, por më pas, të afërmit e tij dëshmuar, se ai kishte marrë trajtim mjekësor

më parë për sëmundje mendore. Pasi foshnja nuk mbijetoi dhe babai i saj u arrestua, gjykata mori vendim që Bibës t'i bëhej vizitatë nga mjekë psikiatër për të konstatuar gjendjen e tij mendore. Pas konsultave të mjekëve, gjykata mori vendim shtrimin e detyruar në psikiatri të Hysen Bibës.

SHKODER U kap nga RENE A, iu gjetën armë në makinë

Rikthehet Shullazi sot vendimi i Apelit

Ministria e Drejtësisë, "ashpërsim" të dënimeve

Lajmi

Procesi në Apelin e Shkodrës ka kohë që ka filluar, por ende nuk ka përfunduar. Në fillim të marsit, ky proces u shty nga trupi gjyqësor i përbërë nga Astrit Kalaja relator dhe gjyqtarët Luan Dervishi dhe Valbona Vata, për mungesën e avokatit mbrojtës të dy të pandehurve.

SHKODËR

Rikthehet për të disatën herë në Gjykatën e Apelit të Shkodrës procesi për Emiliano Shullazin dhe Edison Harizajn, të cilët u arrestuan gushtin e vitit të kaluar gjatë një operacioni të forcave RENE A në dalje të Lezhës, e pikërisht në kryqëzimin e Shëngjinit.

Procesi në Apelin e Shkodrës ka kohë që ka filluar, por ende nuk ka përfunduar. Në fillim të marsit, ky proces u shty nga trupi gjyqësor i përbërë nga Astrit Kalaja relator dhe gjyqtarët Luan Dervishi dhe Valbona Vata, për mungesën e avokatit mbrojtës të dy të pandehurve.

Që prej disa kohësh ministri i Drejtësisë Eduard Halimi ka ngritur me të madhe shqetësimin për kriminalitetin dhe rritjen e dënimeve penale për njerëzit që provohet se i kanë kryer ato. Ndër të tjerë, në kohën e arrestimit të dy të pandehurve, policia hodhi dyshime të forta se vetë dy personat, ishin nisur



NË FOTO: (Majtas) Emiliano Shullazi në sallën e gjyqit (Djathtas) Eduard Halimi Ministër i Drejtësisë

Vendimi

Sot pritet që pas shtyrjes së disa seancave gjyqësore në ngarkim të tij, Gjykata të shprehë për dënimin e dy të arrestuarve. Ministria e Drejtësisë prej më shumë se një muaji ka nisur një fushatë të ashpërsimit të dënimeve penale

të kryerën një tjetër vepër penale, por që nuk specifikohet. Operacioni u krye në masa të forta sigurie dhe pas marrjes së informacioneve paraprake nga zyrtarët e policisë, të cilët nëpërmjet një plani të detajuar, arritën të kapin personat pa arritur të kryejnë veprën për të cilën ishin nisur.

Sipas avokatit mbrojtës, dy të pandehurit kërkojnë që t'u logariten ditët e paraburgimit dhe lirim i tyre, por deri tani, proceset në gjykatën e Apelit

janë shtyrë pikërisht nga mungesa e avokatit. Gjithsesi, Emiliano Shullazi është një emër shumë i



njohur për policinë shqiptare. Ai është përfolur për pjesëmarrjen e tij në disa krime dhe është gjykuar sipas rasteve. Në zgjedhjet e fundit lokale të tetë majit, ka qenë i përfshirë edhe në prishjen e aktivitetit politik, ku rasti më evident dhe i deklaruar publikisht ka qenë ai i Partisë Socialiste, nëpërmjet deklarimeve publike në atë kohë të deputetës së PS, Vasilika Hysi. Edhe në atë kohë ai u ndalua nga policia por më pas u lirë.

Sot pritet që pas shtyrjes së disa seancave gjyqësore në ngarkim të tij, Gjykata të shprehë për dënimin e dy të arrestuarve. Ministria e Drejtësisë prej më shumë se një muaji ka nisur një fushatë të ashpërsimit të dënimeve penale në ngarkim të personave të cilët sipas saj janë përsëritës të këtyre veprave. Ndërkohë që "gjykatat politike" për këtë çështje janë "nxehur" për shkak të rritjes së kriminalitetit në vend.

LAJME SHKURT

Parandalohet vrasja, një 45-vjeçar në pranga
Një 45-vjeçar, banues në Laprakë, është vënë në pranga, pasi ka tentuar të vrasë një person tjetër dy ditë më parë. Policia e kryeqytetit deklaroi, se u arrestua në flagrancë Xhemal Arapi, lindur në Gramsh dhe banues në Laprakë Tiranë. Prangosja e tij është bërë, pasi ai u denoncuar nga Demir Koçi, po nga Lapraka, pasi ai ka tentuar ta vrasë. Nga kontrolli i mjedit tip "Ford Fokus", me targë TR 7853 U, të Xhemal Arapit, postete sediljes i'u gjet një pistoletë "Zastava", me dy kërrera me 11 fishekë, ku njëri prej fishekëve ishte në folenë e armës.

Arrestohet i kërkuari për mashtrim
Policia e Tiranës arrestoi në rrugën "Mine Peza", personin e shpallur në kërkim Erzen Mane, 47 vjecc, lindur në Biliisht dhe banues në Tiranë. Kapja dhe shoqërimi i tij u bë, pasi është shpallur në kërkim më 11 mars, sepse dyshohet, që para rreth tre viteve, ka vjedhur duke mashtruar, një kamion tip "Mercedes Benz", me targa TR 1139 J, Agron Markut. Ai është dërguar në qelitet e paraburgimit, ndërsa brenda pak ditësh, do të paraqitet për masë arresti.

Ndalohet i kërkuari për plagosje
Një person i shpallur në kërkim për plagosje, është vënë dje në prangat e policisë së kryeqytetit. Bëhet fjalë për 56-vjeçarin Nexhat Brahimi, i cili ishte shpallur në kërkim, me datën 18.02.2013, pasi me dt. 17.02.2013, në rrugën "Ali Demi", ka plagosur me mjete të mprehta, pas një konflikti për motive të dobëta, Andrus Alku.

Kapet vlonjati, u dënua në mungesë për vjedhje
KOMISARIATI numër 5, vuri në pranga 18-vjeçarin Enea Lloji, lindur në Vlorë, e banues në Valias të Tiranës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Tiranës, kanë bërë të ditur se, Prokuroria e Tiranës ka dërguar urdhrin e dates. 12.03.2013, për ekzekutimin e Vendimit Penal të datës 1 mars, të Gjykatës së Tiranë, e cila e ka dënua me 4-muj burg për vjedhje në bashkëpunim.

Procesi "Dajti"

Dorëhiqet avokati, kërkohet largimi i gjyqtarit

TIRANE

Dorëheqja e avokatit mbrojtës dhe kërkesës për largimin e kreut të trupit gjyqësor. Me këto zhvillime është karakterizuar dje seanca gjyqësore në Krimet e Rënda në ngarkim të Dritan Dajtit, të akuzuarit për vrasjen e katër policëve, më 7 gusht të 2009-ës. Avokati Saimir Visha është tërhequr nga mbrojtja për Dajtin. "Është hera e dytë që më caktojnë si avokat kryesisht. Nuk e mbroj të pandehurit Dajti, dorëhiqem nga kjo mbrojtje", tha Visha përballë trupit gjyqësor. Ndërsa Dritan Dajti, duke ngritur supet, kërkoi t'i caktojnë një avokat tjetër. "Kur avokati s'pranon,



Dritan Dajti

s'kam çfarë të bëj, më caktoni një tjetër" tha Dritan Dajti. Nga ana e tij, prokurori i çështjes ka kërkuar që gjykimi të vazhdojë pa avokat. Pasi u tërhoq, gjykata vendosi që ky avokat të vazhdojë mbrojtjen e të pandehurit edhe për këtë seancë. Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore, u kërkua nga avokati Vishaj që kryesuesi i trupit gjyqësor Idriz Milkurti të largohet nga gjykimi, me arsyetimin, se ka mosmarrëveshje mes dy palëve. Trupi gjyqësor shty seancën për më 1 prill, ndërkohë që një tjetër trup gjyqësor, do të shqyrtojë kërkesën e avokatit. Dritan Dajti është nën akuzë për vrasjen e katër policëve, Fatos Xhani, Kastriot Peskaj, Sajmir

Duçkollari dhe Altin Dizdari, gjatë një operacioni për arrestimin e tij më 7 gusht të 2009, në qytetin e Durrësit. Dajti akuzohet, se vrau edhe shokun e tij, Ledjon Mara, si dhe plagosi një kalimtar me micaliet F.SH. Mbi 200 seanca gjyqësore janë shtyrë, pasi asnjë avokat nuk pranon të marrë në mbrojtje Dritan Dajtin. Para kaktimit kryesisht të avokatit Visha, Gjykata e Krimeve të Rënda pati vendosur, që Dajti të gjykohej pa avokat, meqenëse asnjë nuk e merr përsipër. Ndërkaj, Byroja për Mbrojtjen e të Burgosurve, e cila ka ofruar mbrojtje për Dajtin, deklaroi, se një vendim i tillë, është shkelje e të drejtave të njeriut.



AKTUALITETET

Tiranë, arrestohet ish-drejtori i bankës vodhi 100 mijë euro

Ish-drejtori një banke të nivelit të dytë L në Tiranë, është arrestuar nga policia e kryeqytetit, pasi akuzohet, se me anë të falsifikimit të dokumenteve, ka vjedhur 100 mijë euro bankës. Hetimet për 37-vjeçarin Gerti Merkollari kishin nisur në 2012, ndërkohë që arrestimi i tij është bërë sot. 37-vjeçari punonte si drejtor i një dege të bankës së nivelit të dytë në Tiranë, deri

tetor 2012. Ndaj tij, prokuroria kishte firmosur në urdhërarrest të vendosur edhe nga gjykata. Ish-drejtori, duke shpërdoruar detyrën tërhoqi para kesh nga llogaritë bankare duke bërë derdhje fiktive në këto llogari dhe duke i shkaktuar dëm në shumën 100 mijë euro”, tha zëdhënësja e policisë Alma Katragjini, në një konferencë për shtyp të orës 15:00.

Sipas policisë, vjedhjen e parave e kishte kryer në bashkëpunim me punonjës të tjerë të bankës, ndërkohë që klientët nuk ishin dëmtuar, sepse lëvizjet në bankë ishin bërë duke u falsifikuar firmat. Vjedhjet ishin kryer mbi një afat kohor 2 vjet dhe në llogaritë bankare të 5 klientëve. Gerti Merkollari akuzohet për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve.

DURRES Bushi i vodhi të atit 500 mijë lekë dhe u zhduk

LAJME SHKURT

Zbulohet pas 10 ditësh pengu i rremë

Arrestohet 18-vjeçari që alarmoi familjen

Lajmi Një djalë 18-vjeçar është arrestuar dje nga policia, pasi kishte sajuar vetë një pengmarrje të rreme, kishte vjedhur në shtëpinë e babait shumën e 500 mijë lekëve. Pas 10 ditësh hetime, Policia e Durrësit, zbuloi se Florenc Bushi, 18 vjeç, kishte sajuar gjithçka.



Florenc Bushim, 18-vjeçari që sajo pengmarrjen

Gjiri i Lalëzit Burime policore tregojnë, se nga verifikimet e numrit të celularit, është bërë e mundur dhe gjetja e vendndodhjes. Ndërsa burime konfidenciale thonë, se mund ta ketë "tradhëtuar" dhe shoku i tij ku kishte shkuar të rrinte.

Kishte marrë lekët e babit, ishte dëfyer në Tiranë, në lokale nate, në hotele të shtrenjta, ndoshta dhe në shoqërinë e femrave. Por, kur buxheti është reduktuar, kishte shkuar në Gjirin e Lalëzit, tek një miku i tij, ku siç duket, edhe kosoja e jetesës është më e lirë. Këtu ka marrë fund dhe aventura që nuk do t'i kushtojë pak 18-vjeçarit Florenc Bushi, nga fshati Draç i Durrësit. Pas afro 10 ditë hetimesh, bëhet e qartë "pengmarrja" e 18-vjeçarit, për të cilën ai edhe u arrestua. Prangosja e tij u bë për akuzën e vjedhjes, të kallëzimit të rremë dhe të njoftimit të rremë në organet e rendit. Policia e Durrësit ka proceduar gjithashtu, në gjendje të lire, një bashkëpunëtor të tij në të ashtuquajturën "pengmarrje" me iniciale S.E. 33 vjeç, banor i fshatit Rrotull Ishëm dhe shok

i Bushit. Historia nisi në 16 mars 2013, kur në polici është paraqitur shtetasi P.B. 38 vjeç, i cili bëri kallëzimin se rreth orës 22.00, është larguar nga banesa djali i tij, shtetasi Florenc Bushi. I njëjti person, pas 24-orëve, deklaroi në polici, se në telefonin e tij kanë mbër-

ritur mesazhe mbi marrjen peng të të birit nga persona të panjohur. Që me marrjen e sinjalizimit të parë, strukturat policore të Durrësit kanë filluar hetimet, të cilat më pas janë zhvilluar në mënyrë intensive në bashkëpunim mes disa strukturave dhe të orientuara nga Prokuroria për Krimet e

Rënda Tiranë. Gjatë veprimeve policore, më datë 25 mars 2013, rreth orës 22.00, gjatë një ndërhyrjeje të realizuar në bashkëpunim me shërbimet operacionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, u bë e mundur gjetja dhe kapja në Gjirin e Lalëzit e 18-vjeçarit Florenc Bushi. Në momentin

që ai është gjetur dhe në derën e shtëpisë së mikut të tij ka parë policinë, ai ka pranuar dhe inskenimin e realizuar prej tij. Madje, sipas policisë, ai ka treguar gjithashtu, se disa ditë para se të largohej nga shtëpia, kishte vjedhur në të një sasi prej 500 mijë lekësh dhe në datën 16 mars 2013, rreth orës 02.00, ishte larguar pa djënjë e prindërve nga banesa, duke shkuar në Tiranë, ku kishte qëndruar në disa lokale me muzikë e hotele të ndryshme. Pas 24 orëve, në telefonin e babait të tij, ai ka dërguar disa mesazhe mbi marrjen peng, duke alarmuar policinë.

Elbasan, klienti grabit 3 kazino Pasi humb një sasi të konsiderueshme parashë në bixhoz, tenton t'i rimarrë duke grabitur kazinotë ku ai ishte klient prej kohësh. Ngjarja u shënu në orët e para të mëngjesit të djeshëm, rreth orës 05:30-06:00 në bulevardin "Aqif Pasha" në Elbasan, ku tre kazino u grabitën nga 33-vjeçari, i cili u arrestua vetëm disa orë pas ngjarjes. Policia tha, se autori është Artur Mehja, i njohur dhe me emrin Elis Mehja. Ai ka grabitur 600 mijë lekë të reja në këto kazino.

Durrës, magazina përfshihet nga flakët Një zjarr i fuqishëm përfshiu dje në mëngjes një magazinë në lagjen 14 në Shkozë të Durrësit. Kanë qenë kalimtarët e rastit ata që kanë konstatuar flakët e zjarrit e kanë njoftuar forcat zjarrfikëse. Është dashur uji i më shumë se 10 makinave zjarrfikëse për të vënë nën kontroll zjarrin, ndërkohë që magazina e djegur shërbente për bimë medicinale. Në momentin e zjarrit, u tha se brenda saj gjendej një sasi sherebeli në gjendje të tharë, çka ka favorizuar zjarrin.

Durrës, kapet grabitësi me maska Policia e Durrësit ka zbardhur një vjedhje me dhunë, të ndodhur në fshatin Rinia 2 ditë më parë. Sipas uniformave blu, pas identifikimit të autorit, u arrestua Ardian Kusaj, 29 vjeç, banues në fshatin Rinia. I prangosuri, në bashkëpunim me një person tjetër, ende i paidentifikuar, dyshohet se rreth orës 22.00, të datës 25 mars, kanë shkuar të maskuar në banesën e A.V., 70 vjeç, dhe pasi i kanë lidhur me litar gjymtyrët, i kanë kontrolluar banesën, në të cilën kanë gjetur e marrë shumën prej 50.000 lekesh.

SHKODER Konflikti

Dy grupe, shkëmbim zjarri në Pedonale

Të rinjtë konfliktohen në lokal, qëllohen me grushta e armë në rrugë. S'ka të plagosur

Kanë qenë duke qëndruar brenda të njëjtit lokal por kanë nisur të debatojnë njeri me tjetrin dhe më pas kanë përdorur armët në qendër të qytetit. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 19:30, pranë godinës së Fakultetit të Shkencave Natyrore në qytetin e Shkodrës. Sipas dëshmitarëve në vendngjarje, dy grupe të rinjsh kanë dalë nga njëri prej klubeve që ndodhet në këtë zonë, në rrugën Pedonale, duke debatuar me zë të lartë dhe më pas kanë nisur të qëllojnë në drejtim të njëri-tjetrit



me grushte, ndërsa dy persona kanë nxjerrë armët pistoleta dhe kanë qëlluar në drejtim të njëri-tjetrit. Fatmirësisht, nga shkëmbimi i zjarrit nuk ka pasur të lënduar apo viktime ndërsa autorët pasi kanë qëlluar janë larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes. Forca të shumta policie kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes që fatmirësisht nuk shënoi ndonjë të plagosur. Vendi ku ka ndodhur ngjarja është mjaft i frekuentuar për shkak se në të kalojnë studentët, por edhe pse ka shumë lokale nate, ndërsa kalimtarët e rastit dhe banorët e zonës

përreth kanë mbetur të shokuar nga shkëmbimi i zjarrit. Forcat e policisë kanë nisur hetimet ndërsa janë duke mblodhur dëshmitë për zbardhjen e ngjarjes dhe prangosjen e autorëve. Forca të shumta policore dhe të forcave special të Shkodrës, kanë ngritur postblloqe në shumë zona, si dhe pikat kyçe të qytetit, ndërkohë që shumë të rinj janë shoqëruar në polici, për të dhënë informacione për ngjarjen e autorët. Deri në orët e mesnatës, policia nuk ka deklaruar, se ka mundur të arrestojë autorët, ndërkohë mësohet se janë shumë afër identifikimit. elna

Shkodër, problem ujrave e zeza Rreth 30 banesa në lagjen periferike "Mark Lula" të qytetit të Shkodrës, prej 3 javësh janë rrethuar nga uji, niveli i të cilit i kalon 20 cm. Banorët shprehen, se situata e tyre është mjaft problematike, ndërkohë që deri më tani nuk kanë patur vemendjen e pushtetit vendor. Problemet sipas tyre kanë ardhur pasi në këtë lagje mungojnë kanalizimet e ujrave të zeza dhe atyre të bardha duke bërë që reshjet e rëna të grumbullohen në oboret e banesave e më pas të vërshojnë drejt banesave.

Abonetë për muajin Prill, me emër mbiemër dhe foto



Problemet me abonët kanë vijuar edhe këtë muaj. Për muajin prill Shoqata e Transportit Qytetas, ka hedhur në treg abone me kartonin shoqëruar, i cili duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe foton e personit që e ble. Sipas kryetarit të Shoqatës së Transportit Qytetas kjo gjë është bërë për

arsye sigurie. "Vendosja e kartonit shoqëruar për abonët dhe në këtë formë është bërë për arsye sigurie. Por edhe që abonët të përdoren vetëm nga një person dhe jo nga të gjithë, ndërsa aboneja e studentit të përdoret vetëm për studentët" thotë Ferdinand Ibrahim. Por për çështjen e aboneve ka reaguar edhe

Bashkia e Tiranës. "Deri sa bashkia të bjerë dakord për një format të kartonit që lufton informalitetin dhe nuk krijon praktika monopol apo antikushpetuese, çdo veprim i njëanshëm nga subjekte të transportit publik, do të çojë automatikisht në hapa të menjëhershëm për heqje license".

Flet Kryetari i Shoqatës së Prindërve Hysni Elezi Programi, nxënësit rrezikojnë karrierën

Maturantët në dilemë për lëndët me zgjedhje



Hysni Elezi kryetari i Shoqatës së Prindërve

Lajmi

Maturantët nuk dinë se cilat lëndë duhet të zgjedhin për plotësimin e formularit A1, që nesër të kenë një profesion që ka vende pune. Kjo ndodh për shkak se në vendin tonë nuk ka një studim për tregun e punës. Edhe pse në shkollë zhvillohet lënda "Edukim për Karrierën".

bëhet" shpreh Elezi. Arsyeja pse nuk zhvillohet kjo lëndë sipas Elezit është se kjo orë është lënë pas dore nga mësuesit. "Arsyetimi është i thjeshtë, mënyra e zhvillimit të kësaj lënde është lënë pas dore, mësuesit janë të patrajtuar e paprofilizuar, mësuesi kujdestar është i ngarkuar dhe nuk ka kohë." Kryetari i Shoqatës së Prindërve shpreh shqetësimin se fëmijët nuk mund të orientojnë për një drejtim pa ditur tregun e punës "E si mund të orientojnë fëmijët për të zgjedhur një degë të caktuar, që më pas të gjejnë një vend pune pa ditur drejtimet e zhvillimit ekonomik? Arsimiti nuk mund të bëhet sot për nesër, apo vetëm sa për një periudhë zgjedhore, siç vepohet me planet e fushatës, ku mashtrrohet populli me plane vulgare e pa baza reale, por ai bëhet për perspektivën e gjithë jetës. Nxënësit dhe prindërit, përveç kësaj, nuk dinë se në cilin universitet është më mirë, në cilën lëndë e degë programet përafrohen me tregun e punës" thotë Hysni Elezi. Më tej Elezi shpreh "Udhëzimi i MASH-it për universitetet që 'degët' i kenë sipas tregut të punës", por cili është tregu i punës që ne nuk e dimë? Me shembullin e pushtetarëve e fëmijët thonë se nuk ka nevojë për studime, mjafton diploma dhe pastaj të zhvasim, të bërtasim se kemi të drejtë," përfundon Elezi

Objektivi

Kjo lëndë ka si synim të zhvillojë të nxënësit aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë.

TIRANE

JONIDA LATE

Maturantët në dilemë për të zgjedhur lëndët që duhet të plotësojnë në formularin A1, lëndë këto që do tu shërbejnë më vonë për profesionin që do të kenë në të ardhmen. Shkak i kësaj dileme të tyre është bërë arsyeja se në vendin tonë nuk ka një studim për tregun e punës. Edhe pse në shkollë zhvillohet lënda "Edukim për Karrierën", ku nxënësit të orientojnë për tregun e punës. Por, duket se kjo lëndë është vetëm formale. Kryetari i shoqatës së prindërve Hysni Elezi shpreh shqetësim për këtë gjë "Lënda e "Edukim për karrierën" fillon që në klasën e nëntë dhe vazhdon dhe në shkollën e mesme, por këto janë dhe mbeten formalisht nëpër letra, pasi praktikisht nuk bëhet asgjë. Kjo lëndë, në shumicën e rasteve lihet aq pas dore, sa shërben për të plotësuar normën e ndonjë mësuesi jashtë profilit. Të orientojnë nxënë-



Libri Edukim për Karrierën

sin për zhvillimin e karrierës, duhet t'a njohësh atë në tërë vepërimitarë dhe sjelljen e tij, jo vetëm në mësim. Mësuesi kujdestar duhet të jetë ai që duhet të bashkërendojë punën me shkollën e prindërit, duhet të marrë mendimin e të gjithë mësuesve të tjerë për talentin e secilit, dhe t'i japë informacion mësuesit që zhvillon lëndën për zhvillimin e karrierës, por të gjithë e dimë që kjo nuk bëhet. Edhe mësuesi i kësaj lënde duhet të bëjë ministudime për 'potencialin' që ka secili nxënës, edhe këtë të gjithë e dimë që nuk

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 109, datë 13.02.2013 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Dobrenjë - Tomoricë" dhe miratimin e bonusit në procedurën përgjyeshje konkurrese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurrese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurrese për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Dobrenjë - Tomoricë".

1. Kërket, që projekti të realizohet në pellgun ujëmbledhës të përrënje të Hijes dhe Burranja nga fillimet e rrjedhve deri në derdhje në lumin e Tomoricës.
2. Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al.
3. Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
4. Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
6. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurimit në bazë të shtetësisë.
7. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 25/04/2013, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
8. Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 25/04/2013, ora 12:00.
9. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

MerrJep.al

Blije atë që të duhet!

Shite atë që nuk të duhet!

Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Për më shumë informacion na vizitoni në faqen tonë të website:


www.MerrJep.al

KËRKOJ APARATE FOTOGRAFIK METALIK TË VJETËR

Tiranë, kërkoj të blej Aparate Fotografik Metalik të vjetër. Koleksionoj aparate fotografike të vjetër të të gjitha markave. TEL+35569688088

PEUGEOT 206 BENZINË 1.1CC,
Shes Peugeot 206 motor 1.1cc benzinë me dokumenta të rregullta targa Italiane. Makina ka 120.000 km, origjinale me 4 dyer, tapiceri super e pastër me goma të reja të sapo vëna me faturë HANKOOK, disqe alumini, kasetofon mp3. TEL. 0686803203

IPHONE 5 FACTORY UNLOCK
Iphone 5 factory unlock i ardhur nga Italia shumë pak i përdorur as një muaj 16 gb i bardhë. TEL. 0692401666



Një kafe me doktorin...

Po në fakt, ç'do gjë kalon nga krevati?



NGA ANILA BASHA

vijon nga faqja 1

...m'u drejtuan mua dhe e dija që doktori do ta kishte në majë të gjuhës shprehjen se "çudia më e madhe tre ditë zgjat", e se vetë atë, as ata të PS nuk e kishin linquar kaq shumë për deklaratat e tij në Kuvend, sidomos ato me sharje me fis e me farë. Tani që u qetësua disi situata, shkova ta takoj për një tjetër çështje: Çfarë po ndodh me statutet në facebook të ministrave, por ajo që më tërhoqi ditën e djeshme, statusi i ministres së Integritimit Malinda Bregu lidhur me bashkëshorten e kryetarit të PS, Edi Rama.

Unë: Si je doktor, më dukesh pak

i lodhur...

At: Eja, eja Anila. Dhe ti nuk ke kaluar pak gjithë këtë kohë. Si e kalove? Mos u merrzit. Kalon gjithçka. Gabim të madh bëre. Po nejshe, pas kaq kohe, ç'e mirë të ka sjellë.

Unë: Falemnderit doktor që më pyet. Situatë e vështirë ishte me thënë të drejtën. Por të shpresojmë që do të kemi ndërgjegjesim më të madh të gjithë, pas kësaj që ndodhi.

Dhe unë që mendova për një situatë që nuk do të acarohet politikisht. Por dje, ç'të shihja: Pashë statusin gjithë ironi të ministres së Integritimit për bashkëshorten e kreut të PS, Linda Rama. Ndoqa dhe humorin me spec, gati gati në grotesk, të Hervin Çulit, Xhevahir Zenelit dhe miqve, në emisionin "Paçe me gazeta" në A1Report. Unë e di që ti e di se përse e kam fjalën, por për lexuesit, po e sqaroj se bëhet fjalë për deklaratën e ministres në facebook se meqë zonja Linda Basha punon me projekte të integritimit në Kosovë, mirë do të ishte ta punësonte qeveria shqiptare për të bindur të shoqin, pa kryetarin e PS, që t'i lejojë deputetët



NË FOTO: Kryeministri Sali Berisha

e vet për të votuar tre ligjet. Madje zonja Bregu thotë se nuk e di sesa paguhet në Kosovë, por mund edhe të kishte dialoguar për rrogën...!!!!

Humoristi Xhevahir Zeneli tha dje se gjithçka kalon nga krevati dhe mund ta kishte mirë kjo min-

istre e meçur për ti bërë presion Ramës. Ajo që më habiti është fakti sesi ka mundësi që ju vetë e keni urdhëruar ministren të hedhë një status të tillë në facebook. Se me thënë të drejtën Doktor, dihet fare mirë se vetëm në PS, "flasin poshtë e përpjetë" pa urdhrin e kryetarit. Të PD-ja e në qeveri, s'bëhet fjalë të dalë diçka në publik pa lejen tuaj. Nuk kemi dëgjuar deri tani askënd nga PS të flasë për zonjen Liri Berisha, një doktoreshë që merret me profesionin e saj dhe me aktivitetin si bashkëshortja e kryeministrit. Pa dashur të bëjë avokaten e zonjës Linda Basha se ajo punët e veta bën, si në Kosovë, apo edhe në Shqipëri, një mendim kam: nuk do të ishte mirë që gratë tuaja, pra ajo e Ramës dhe grua juaj, të mos përfshiheshin që tani në fushata të tilla denigruese? Se ka kohë deri në fillimin e fushatës për të ndërmarrë këtë aksion. Askush nuk do ta ndalë dot këtë "histeri" që nis e nuk përfundon karshi femrës, por të gjithë duhet të bëjmë të paktën minimalen për të parë në sy njëritjetrin, në shenjë respekti.

Koment

Kushi dhe Kurrkushi



NGA ARDIAN NDRÉCA

vijon nga faqja 1

...udhetime turistike, ka qenë mbledhja e firmave për një peticion sa idiot aq edhe të pazakontë, mbasi formulohet dhe mbështetet prej atyne që mbajnë pushtetin, kur e dijme se instrumenti i peticionit përdoret pikërisht për me iu drejtue atyne që e janë në pushtet; shpallni faqe botës se

zonja Kushi e kishte firmosë atë peticion drejtue/kundër Edi Ramës.

Pa e dëjtë, pse zakonisht gjanat dihen vetëm kur reflektohet rreth tyre, ajo e nxori Edi Ramën si një leader liberal (gja që nuk duhet të jetë edhe aq e vërtetë), që kandidon edhe njerëz që nuk janë dakord me të. Do të isha kurioz me dëjtë nëse Sali Berisha do ta kandidojë rishitas Mark Markun,

due qenë se ky i bani vjet një dy tentativa të ndrojtuna me ia kritikue linjën politike dhe praktikak në parti!?

Lista me firmat e peticionit asht tepër heterogjene, ka në të njerëz që vlejné, ka edhe shumë tjerë që dëjnë vetëm me vu firmën. Reagimi i speakers u tregoi qartë firmatarëve se janë të "komprometuem" me pushtetin dhe se nuk janë të lirë deri në fund. Kjo histori

firmash na kujton do firma tjera që shumë prej atyne që hyjnë e dalin në politikë e në administratë i kanë hjedhë dikur përpara ndonji operativit të DPB. Ato firma dhe dosjet që nuk po hapen ende i kanë dhanë pushtet dhe garancina kryesisht tre njerëzve shumë të afërt njeni me tjetrin: Nexhmije Hoxhës, Ramiz Alisë dhe Sali Berishës. Ma qartë se kurrëgjia ketë gjë e tregoi farsa e zgjedhjes së

presidentit të Republikës.

Prania e firmave të shumë njerëzve që punojnë për shtetin në fund të atij peticioni spjegohet thjesht me faktin se ky pushtshtet i ka lidhë me bukën e gojës e s'kanë kah me ia mbajtë. Pra, ma shumë se çështje forcat ai peticion asht një çështje dobësisht.

Nga një anë qëndron në dobësinë e vet Kushi, ndërsa në anën tjetër zgërdhiet në forcën e vet të dobte Kurrkushi.

Blog / Grimca Urbane

Punë kafenesh...



NGA EVIS CERGA

Më pëlqejnë kafenetë. Në fakt ka vite që më pëlqejnë. Ato nuk e kanë humbur asnjëherë "shkëlqimin" e tyre për mua. E kam nisur lidhjen time me to që në moshën studentore, si fillim për të pirë ndonjë lëng frutash shoqëruar me ndonjë variant byreku "të jashtëm", për të vazhduar më

vonë me croissant dhe kafe. Kjo ishte zana filla. Kafen e mësova në një qytet kafedashës. Në Kairo. Por përvec kafes mësova edhe sesi të lexoj në kafene. Po, po pikërisht, të lexoj. Në kafenetë e Kairos njerëzit pinin kafe, por edhe lexonin gazeta, revista të blera në kioskën pranë kafenesë ose ndonjë libër të cillin e ndërromin cdo një javë ose dy. E përqafova edhe unë këtë rit dhe e solla me vete edhe në mëmëdhe, ku u prit me skepticizëm, simpati, përcmin, ironi, shpoti, kuptohet, nga klientët e kafeneve. Kjo jo vetëm që nuk ma preu hovin e leximit, por përkundrazi më nxiti të fitoj edhe një "hobi" tjetër të shumë shqiptarëve. Fjalëkryqin. Tani unë jo vetëm që mund të lexoja, por fjalëkryqi do të më ndihmonte të përdorja edhe

trurin...Por shumë shpejt mësova që kjo e fundit nuk qe e thënë sepse fjalëkryqi përbëhej nga elementë të tillë si: dy germat e fundit të fjalës "koreograf", tre germat e mesit të fjalës "rapitograf" dhe dy të fundit të fjalës "ilustraxhi", ose person që dikur ju lyente këpucët në dyqan dhe tani ja u lyen në udhëkryq...

Por kafeneja më ndihmoi të mprehja shqisat edhe në dy fusha të tjera, të përqafuara rishitazi edhe nga vetë bashkëkombasit e mi. Ato të modës dhe psikologjisë sociale.

Alta moda ose basamoda, më mirë me thënë, i shkon shumë për shtat kafeneve të qytetit tim. Vajza të lyera që në mëngjes herët sikur sapo kanë dalë nga provat e programit "Rosaku i Shëmtuar" (ndonëse në këtë program gjasat janë që të

përmirësohen), me taka të larta, me funde të shkurtra, me sy të lyer në të tillë dërxehë që nuk kuptohen ky fillon syri dhe ku është veshi koreospondues, me buzë të ngjashme me kamare dhe me një ecje, gjithë stil, të tipit ala Xhepeto. Ngaqë kanë taka të larta, zërat i kanë edhe më të lartë ngaqë kanë hall të shkretat (mendoj unë) se mos nuk i dëgjojnë shoqet që janë poshtë.

Por vajzat nuk vijnë në kafene vetëm (si fjala ndonjëra). Ato shoqërohen me djem-burra të moshës 20-30-40-50 vjecare (këtë e kam vështirë të përcaktoj sepse jeta e mëparshme i ka lodhur ca të lart-përmendurit). Këta djelmosha me barqe të tipit bullgaro-rus kanë veshje po aq ekzotike sa edhe ato të AltaTakave. Ata i gjen me veshje

që variojnë që nga tutat (sigurisht Armani) tek kostumet Hugo Boss (e ka të shkuruar tek etiketa e mëngës së majtë). Këpucët e tyre janë shpesh ilustrafine, në formë varke, por edhe hera-herës me tegela të bardhë. Zërat e tyre në kafene u ngajnë britmave kundër arbitrit në stadium dhe tonet e zërit "Urraa"-së kur skuadra e zemrës ka shënuar. Me një fjalë me valë.

Temat e bisedave që shoqërojnë pijet energjike (apo energjitiqe, nuk i dihet) në orët e para të mëngjesit janë të shumëllojshme sikundërse edhe tema e bisedave. Por unë po përmend vetëm njërin syresh. Ku do e pim kafen nesër?

Dhe meqë edhe mua po më bëhet vonë për kafe e lëmë për kafe nga java tjetër.

SHËNDETI

E ENJTE 28.03.2013

BOTIM I PËRJVASHËM I GAZETËS SHQIPTARJA.COM



Sport në fëmijëri, mendje të freskët pas të 50-ave

Ç'sport të zgjidhni për të vegjelët tuaj

Kush merret me sport rregullisht, që në fëmijëri, ka një kujtesë, vëmendje dhe aftësi të të mësuarit më të mira edhe pas të 50-ave vjet. Ky është rezultati i një studimi

të kryer nga London King's College dhe është publikuar në "Psychological Medicine". Dhe sa më e qëndrueshme të jetë aktiviteti fizik, dhe sa më shumë intesitet... **Faqe 16**



Acidi Larixic çon kancerin në "vetëvrasje"

Substanca gjendet në birra, kafe dhe arrë kokosi

Acidi larixic, i cili njihet Andryshe si maltol, mund të ketë një funksion antitumor, duke ndihmuar për të ndërtuar klasa të molekulave, që çojnë në "vetëvrasje"

qelizat e sëmura. Për të evidentuar efektin antikancer të kësaj substance natyrore që gjendet në birra, çikore, arrën e kokosit dhe kafe, janë angazhuar dy... **Faqe 17**

A ESHTË E RREZIKSHME KRIPA PER SHENDETIN NESE KONSUMOHET PA KRITER

Kripa, për sa kemi nevojë

Gjella me kripë e kripa me karar. Sipas statistikave rreth 90% e popullatës konsumon 10 gramë kripë në ditë, kur norma e lejuar nga OBSH është vetëm 5 gramë

■ ■ ■ TIRANE

Gjella me kripë e kripa me karar. Ky është apeli që bën shefja e Sektorit të Stilit të Jetesës në Departamentin e Promocionit në Institutin e Shëndetit Publik, Jeta Lakrori. Ajo thekson se kripa ushqimore është lëndë e rëndësishme për ushqyerjen dhe nuk është gjë tjetër veçse klorur natriumi apo NaCl që përmban përkatësisht 40% natrium dhe 60% klorur. "Trupi ynë për të funksionuar ashtu siç duhet, ka nevojë për kripë apo natrium për shkak se natriumi është element i rëndësishëm për organizmin tonë. Natriumi ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit të lëngjeve në trupin tonë, ndihmon në rregullimin e presionit arterial, ndihmon në transmetimin e impulseve nervore dhe ndikon në kontraktimin dhe relaksimimin e muskujve", - shpjegon Jeta Lakrori duke shtuar se natriumi është elementi esencial që rregullon... **Vijon në faqen 14**



Luleshtrydhja

2.5 vjet më shumë për trurin e femrës



Ngjyra e kuqe, aroma e mrekullueshme dhe shija e veçantë bëjnë që luleshtrydhet të jenë frutat më të pëlqyera jo vetëm të fëmijëve, por edhe të të rriturve. Janë një mijë e një arsye se përse nuk duhet t'i ndajmë kurrë nga tavolina. Në mjekësinë popullore luleshtrydhja është ilaçi që mund të shërojë më shumë sëmundje dhe të përdoret kudo. Ata mbahen si një nga ushqimet më përmbajtje më të lartë të vitaminë C. Po ashtu ajo ka dhe vlera të larta mjekësore duke veçuar këtu vetinë e saj të madhe antioksiduese. Mendohet se sa më shumë të skuqet fruti, aq më shumë atij i rriten vlerat antioksiduese. Po ashtu luleshtrydhja ka veti mbrojtëse ndaj radikaleve të lira, të cilat shkaktojnë... **Faqe 17**


Gjenetikë

Faqe 15

Sëmundjet që prekin shqiptarët

Eksperti Grigor Zoraqi: Me bazë gjenetike dhe diabeti e tumoret

Janë sëmundje që një foshnje i merr që në momentin që ngjizet në barkun e nënës, por që i ndryshon krejtësisht jetën si fëmijës ashtu edhe familjes së tij. Këto sëmundje mund të shmangen, nëse gjatë shtatzanisë kryhen kontrolle tek specialistët. Sipas gjenetistit të njohur, Grigor Zoraqi, deri më tani njihen rreth 6 mijë sëmundje me bazë gjenetike, ku nuk ngelen jashtë as tumoret, diabeti apo sëmundjet e zemrës.



"Sëmundjet gjenetike ose ata të trashëgueshme janë ato sëmundje, ku është përgjegjëse për deformimin një gjen i vetëm. Këto sëmundje transmetohen nga një brez në tjetrin, sipas rregullave të gjenetikës, dhe përgjithësisht kanë një risk për t'u shfaqur nga njëri brez në tjetrin në një mënyrë konstante. Këto sëmundje janë në një numër mjaft të madh, janë rreth 6 mijë të identifikuara, për të cilat janë gjetur edhe gjenet përgjegjëse për..."

Këshilla

Kripa, sa kemi nevojë pa rrezikuar shëndetin

Si të evitoni tejngopjen e pjatës me kripë

JETA LAKRORI
Specialiste në ISHP



...sasinë e lëngjeve në trupin tonë, ai e mban trupin të hidraturar duke shtyrë ujin brenda në qelizë. Por nga ana tjetër ajo thekson se natriumi duhet ruajtur dhe veshkat janë balanca natyrale që ruan sasinë e natriumit në trupin tonë për një shëndet sa më të mirë. Ato ndihmojnë në rregullimin e sasisë së natriumit në organizëm, nëse niveli i natriumit është ulët, hormoni i aldosteronit stimulon veshkat për rithithje të natriumit nga urina dhe e konservon atë,

Kripa që duhet përdorur në konsumin e përditshëm është kripja e jodizuar e cila është kripë e zakonshme, por i është shtuar jodi. Jodi është i domosdoshëm për zhvillimin normal sidomos të gjëndrës tiroide

nëse niveli i natriumit është i lartë hormoni i aldosteronit nuk aktivizohet dhe veshkat e eliminojnë natriumin nëpërmjet urinimit.

SASIA E KRIPËS

Por natyrshëm lind pyetja për sa kripë ka nevojë organizmi ynë. "Përdorimi i kripës është i ndryshëm nga një vend në tjetrin. Europa ku bëjmë pjesë në përdorimi i kripës është në nivele të larta 10 deri 12 gram në ditë. Nga studimet në botë meshkujt janë konsumatorë më të mëdhenj se femrat dhe vendet ku konsumohet më shumë kripë janë Kina, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA", pohon Jeta Lakrori. Por OBSH dhe FAO prej vitesh, për të parandaluar sëmundjet kronike, kanë rekomanduar që kripa e marrë duhet të reduktohet deri në më pak se 5 gr/ditë (2gr natrium/d). Ndërkohë specialistja shpjegon edhe se çfarë ndodh nëse ka marrje të pakët apo të shtuar të kripës. "Në kushte normale organizmi ynë eliminon çdo ditë 0,1gr deri në 0,6gr natrium (sodium). Kjo sasi rritohet me dietën nëpërmjet ngrënies. Nuk është e nevojshme t'ju shtohet kripë ushqimeve mbasi sasia e natriumit që ndodhet në ushqimet natyrale të pa gatuar, është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e organizmit", - pohon Jeta Lakrori duke shtuar se mungesa e marrjes së kripës është e rrallë. Por nëse takohet shenjat që mund të kenë individët janë: plogështia, dhimbjet dhe ngërçet në muskuj; të përzjera, të vjella.

KRIPA E JODIZUAR

Ndërsa sa i takon kripën që duhet përdorur specialistja shpjegon se në treg ka disa lloje kripash. "Por kripa që duhet përdorur në konsumin e përditshëm është kripja e jodizuar e cila është kripë e zakonshme, por i është shtuar jodi. Jodi është i domosdoshëm për zhvillimin dhe funksionimin normal sidomos të gjëndrës tiroide, e cila me prandimin e hormonit të rritjes bën

të mundur rritjen, zhvillimin dhe funksionimin normal të organeve të tjera. Kripa e jodizuar ka të njëjtën shije dhe karakteristika si kripa e zakonshme", - shpjegon Jeta Lakrori duke theksuar se kripa e jodizuar është një ushqim që duhet përdorur në mënyrë korrekte, nga e gjithë popullsia, në të gjitha moshat dhe në sasi të moderuar sipas rekomandimit për kripën e zakonshme, jo më shumë se 5 gram /ditë.

Nevojat ditore për kripë sipas moshës

Mosha	Sasia e kripës në gram	Sasia e natriumit
0-6m	1gr/ditë	0,4gr Na
7-12m;	1gr/ditë	0,4gr Na
1-3 vjeç	2gr/ditë	0,8 grNa
4-8 vjeç	3gr/ditë	1,2 grNa
9-50 vjeç	4gr/ditë	1,5 gr Na
50-70 vjeç	3gr/ditë	1,2 gr Na

Si e marrim kripën

Burimet kryesore të natriumit në ushqime

Burimet kryesore të natriumit në ushqime janë të natyrave të ndryshme:

65-70% e natriumit gjendet si përbërës i ushqimeve të përpunuara dhe të përgatitura, të transformuara si në mënyrë artizanale apo industriale si edhe ushqimet e ngrëna jashtë shtëpisë. Këto ushqime kanë zakonisht sasi të lartë kripe si edhe kanë aditivë që përmbajnë natrium. Ushqime të përpunuara janë bukë, darka e përgatitur si, makarona, mish dhe vezë enët, pica, shkurtime e ftohtë dhe proshutë, djathë, supat e ushqimet e shpejta. 15% e natriumit gjendet si përbërës i ushqimeve në gjendjen e tyre natyrale, të papërpunuara, si: ujit, frutave, zarzavateve, mishit, vezës, qumështit dhe produkteve të tij, peshkut, etj



15-20% e natriumit gjendet si përbërës i kripës së gjellës që i shtojmë në gatimet shtëpiake ose

në tavolinë. Midis produkteve të transformuara burimi kryesor i kripës në ushqyerjen tonë të zakonshme është buka dhe prodhimet e furës të cilat sjellin 40% të kripës në organizmin tonë. Në të vërtetë produktet e drithërave janë burim i rëndësishëm i kripës sepse ato konsumohet në mënyrë të përditshme, si: biskotat e ndryshme, byrekët, ëmbëlsirat e ndryshme, krakersat, cerealet e mëngjesit, kekrat e ndryshme, etj dhe zakonisht këto ushqime përmbajnë më shumë kripë nga sa ne mendojmë. Psh 50 gr bukë apo një fetë përmban 0,4 gr kripë, cerealet e mëngjesit 30 gr apo 4 lugë gjelle përmbajnë 0,8 gr kripë, 20 gr biskota ose 2-4 biskota të ëmbla përmbajnë 0,1 gr kripë, 1 copë kek 35 gr përmban 0,3 gr

kripë, etj. Ndërsa mishi dhe produktet e tij sjellin 21 % të kripës në organizmin tonë, por konsumohen më pak se buka dhe produktet e saj, si: mishrat, sallamrat, djathin, konservat e peshkut, etj. Proshuta krudo 50 gr (3-4 feta mesatare) përmban 3,2gram kripë etj. Qumështi dhe produktet e tij, si djathrat, gjiza, kanë sasi të ndryshme kripe. Disa lloj salcash apo erëzash që përdoren në zëvendësim apo shtim të kripës janë të pasura me natrium. Psh pluhurat apo tabletat e zarzavateve 1 tabletë 12gram (dado) përmban 4,8gram kripë, 14 gr (1 lugë gjelle), ketchup përmban 0,4 gramë kripë, salsa e sojë, etj, prandaj duhet përdorur me kujdes apo në mënyrë të moderuar.

Këshilla për përdorimin e kripës

- Kufizoni gradualisht përdorimin e kripës si në gatim edhe në tavolinë

- Përdorni kripën e jodizuar dhe jo kripën e zakonshme, 1 lugë e vogël ka 6 gram kripë

- Mos shtoni kripë në ushqimet e fëmijëve sidomos deri në një vjeç

- Kufizoni përdorimin e elementeve që përmbajnë natrium, si salcat, kubetat e lëngjeve, etj

- Jepini shije ushqimeve me erëza aromatike, si: hudhër, qepë, majdanoz, baziliko, rozmarinë, rigon, sherebelë, nenexhik, presh, si dhe produktet të tilla si: piper, spec djegës, arëmysku, etj

- Shtoni shijen e ushqimeve duke shtuar uthull apo lëng limoni

- Lexoni etiketat e ushqimeve të paketuara për sasinë e natriumit (Sasia është e lartë nëse për 100 gr produkt ka 1,5gr kripë ose 0,6gr natrium/sodium) dhe (Sasia është e ulët nëse për 100 gr produkt ka 0,3gr kripë ose 0,1gr natrium/sodium)

- Kripa e jodizuar duhet të mbahet në enë të mblytur mirë dhe në vende pa lagështi, sepse jodi humbet nga dielli dhe lagështira

- Kripa e jodizuar duhet të hidhet gjellës në fund të gatimit mbasi jodi avullon

Gjenetikë

Sëmundjet gjenetike që prekin shqiptarët


Zoraqi: Me bazë gjenetike dhe diabeti e tumoret

ESMERALDA KETA

Janë sëmundje që një foshnje i merr që në momentin që ngjizet në barkun e nënës, por që i ndryshon krejtësisht jetën si fëmijës ashtu edhe familjes së tij. Këto sëmundje mund të shmangen, nëse gjatë shtatzanisë kryhen kontrole tek specialistët. Sipas gjenetistit të njohur, Grigor Zoraqi, deri më tani njihen rreth 6 mijë sëmundje me bazë gjenetike, ku nuk ngelen jashtë as tumoret, diabeti apo sëmundjet e zemrës.

"Sëmundjet gjenetike ose ata të trashëgueshme janë ato sëmundje, ku është përgjegjëse për deformimin një gjen i vetëm. Këto sëmundje transmetohen nga një brez në tjetrin, sipas rregullave të gjenetikës, dhe përgjithësisht kanë një risk për t'u shfaqur nga njëri brez në tjetrin në një mënyrë konstante. Këto sëmundje janë në një numër mjaft të madh, janë rreth 6 mijë të identifikuar, për të cilat janë gjetur edhe gjenet përgjegjëse për këto sëmundje. Por baza e sëmundjes gjenetike është shumë më e gjerë. Sipas studimeve të fundit, edhe ato që quhen sëmundje shumë të përhapura kanë një bazë gjenetike, për të mos thënë se të gjitha sëmundjet kanë bazë gjenetike. Siç janë sëmundjet kardiovaskulare, tumoret, diabeti, që janë edhe shkaktarët kryesorë të vdekshmërisë së popullatës. Në ndryshim nga sëmundjet mirëfilli gjenetike, në këtë rast deformimi nuk është pasojë e një gjeni të vetëm, por e disa gjeneve së bashku. Kështu pra, është vërtetuar se edhe këto sëmundje kanë një bazë të fortë gjenetike. Për disa prej tyre janë identifikuar edhe gjenet përgjegjëse, aq sa ekzistojnë teste parashikuese, parandaluese për këto sëmundje. Për kardiovaskularet, kancerin, apo diabetin kemi disa teste, siç është hiperkolesterolemia familjare, që kur ke një defekt në një gjen të caktuar, ke një predispozitë për të pasur kolesterolin e lartë dhe tensionin e gjatë. Po kështu, kur ke një defekt në gjenin BRCA, kanceri i gjirit, ke gati 100% rrezik që të shfaqet kanceri i gjirit, sidomos kur kjo ka ndodhur edhe tek nëna edhe tek gjyshja. Po kështu, ekziston një gjen i vetëm që përçakton shfaqjen e diabetit edhe në moshë mjaft të re. Më këto tre shembuj doja të thosha se edhe në sëmundjet e mëdha që shkaktojnë shumicën e vdekjeve, janë identifikuar gjene të njëjta me ata që ne i quajmë sëmundje gjenetike", - na shpjegon gjenetisti Zoraqi.

Më tej ai na shpjegon se nuk ka ndonjë studim të veçantë për popullatën shqiptare, por për evidentimin e tyre përdoret e njëta mënyrë si në vendet e tjera. "Megjithatë futen në kategorinë e sëmundjeve të rralla, për shkak të numrit të madh të tyre (rreth 6 mijë), edhe përqindja e fëmijëve që lindin me sëmundje gjenetike bëhet e madhe. Mendohet që 3% e fëmijëve (3 fëmijë në 100 lindje), lindin me anomali gjenetike, pavarësisht se sa e rëndë mund



të jetë njëra apo tjetra anomali. Prandaj, fakti që disa prej këtyre sëmundjeve janë të përhapura në popullatën e caktuar, siç është rasti i talasemisë në popullatën e Mesdheut apo fibroza cistike në popullatën e racës së bardhë në Evropë e Amerikë dhe për koston e lartë që ka trajtimi i tyre, duhet të studiohen dhe parandalohen këto lloj sëmundjesh gjenetike. Në lidhje me përhapjen e tyre, neve njohim nga literatura se sa janë përhapur në zona të ndryshme sëmundje të ndryshme gjenetike. Në vendin tonë janë bërë disa studime, jo të plota, por ne kemi disa të dhëna për talaseminë dhe fibrozën cistike. Në bazë të analizave të hemoglobinës, mendohet të kemi deri në 300 mijë mbartës të këtyre

sëmundjeve të talasemisë dhe për fibrozën cistike (ky numër është nga literatura), 1 në 25 persona është mbartës (i fibrozës cistike). Pra, rreziku për të lindur një fëmijë me fibrozë cistike është 1 në 2500 fëmijë, për talaseminë 1 në 2000 lindje. Ndërsa distrofia muskulare, që është një sëmundje që lidhet me kromozonin X, pra një sëmundje e lidhur me seksin, kryesisht shëruen meshkujt që kanë një kromozon X dhe nuk e kanë kromozonin e dytë X, siç e kanë femrat dhe njëri prej tyre mund të jetë në rregull, gjë që bën që fëmija të lind i shëndetshëm. Edhe këto sëmundje shfaqen 1 në 2500 lindje meshkuj, ndërsa për sa u përket femrave, probabiliteti është shumë më i ulët. Sëmundje tjetër gjenetike është

edhe atrofia muskulare spinale, ku sipas përlogaritjeve mund të lindë 1 në 4000 lindje. Përqindja e mbartësve, qoftë për atrofien, qoftë për distrofinë nuk është e njohur. Njëkohësisht, në grupin e madh të anomalive gjenetike është e njohur edhe sindroma e Doën-it, e cila është e përhapur në varësi të moshës së nënës", - shpjegon më tej Zoraqi.

Ndërsa sa i përket sindromës doën, ai na shpjegon edhe ndikimin që ka mosha e nënës me lindjen e fëmijëve me këtë sindromë.

"Nëse mosha e nënës është rreth 24 vjeç, probabiliteti për të lindur një fëmijë me sindromën Doën është 1 në 1350 lindje, por nëse mosha e nënës është mbi 50 vjeç ky probabilitet është 1 në 50 fëmijë. Mosha e nënës ka të bëjë me këtë anomali gjenetike, pasi sindroma e doën-it quhet ndryshe trizomia 21, pasi në vend të dy kromozomeve 21, ka tri kromozome 21. Që do të thotë se qeliza e nënës, në vend që të mbajë një qelizë 21 dhe një ta marrë nga prindi babë, për të formuar dy kromozome 21, ka mbajtur dy të tilla. Pra, ka ndodhur ajo që quhet mosdarje e saktë qelizore, dhe kjo vjen si pasojë e moshës së nënës. Dihet që prodhimi i gametave seksuale femërore bëhet e gjitha njëkohësisht, pra të gjitha qelizat seksuale femërore prodhohen njëherë dhe qëndrojnë atje për aq vite derisa vazhdon cikli riprodhues i femrës. Dhe sa më gjatë qëndron në mjedisin femëror dhe kur ndodh fekundimi, kohëzgjatja bën që të plakët mekanizmi i ndarjes së qelizës. Pra, sa më e madhe të jetë mosha e nënës, aq më i madh është probabiliteti i mosdarjes së këtyre qelizave dhe të krijohen qeliza me anomali kromozomike. Në moshën mbi 40

Sa janë të prekur shqiptarët?

■ **Talasemia**

Në bazë të analizave të hemoglobinës, mendohet të kemi deri në 300 mijë mbartës të këtyre sëmundjeve të talasemisë.

■ **Fibroza cistike**

Për fibrozën cistike (ky numër është nga literatura), 1 në 25 persona është mbartës (i fibrozës cistike). Pra, rreziku për të lindur një fëmijë me fibrozë cistike është 1 në 2500 fëmijë, për talaseminë 1 në 2000 lindje.

■ **Distrofia muskulare**

Ndërsa distrofia muskulare shfaqet 1 në 2500 lindje meshkuj, ndërsa për sa u përket femrave, probabiliteti është shumë më i ulët.

■ **Atrofia muskulare**

Sëmundje tjetër gjenetike është edhe atrofia muskulare spinale, ku sipas përlogaritjeve mund të lindë 1 në 4000 lindje. Përqindja e mbartësve, qoftë për atrofien, qoftë për distrofinë nuk është e njohur.

■ **Sindroma Doën**


Njëkohësisht, në grupin e madh të anomalive gjenetike është e njohur edhe sindroma e Doën-it, e cila është e përhapur në varësi të moshës së nënës

vjeç, risku bëhet shumë i lartë. Këtu tek ne nuk është se ka ndonjë studim, por në vit lindin rreth 100 fëmijë me sindromën Doën, duke marrë parasysh grupmoshat e ndryshme probabiliteti është 1-700 fëmijë. Këto janë sëmundjet më të përhapura në vendin tonë, ato që mund të analizohen dhe të parandalohen".

Zgjidhja

Acidi Larixic çon kancerin në "vetëvrasje"

Acidi larixic, i cili njihet Andryshe si maltol, mund të ketë një funksion antitumor, duke ndihmuar për të ndërtuar klasa të molekulave, që çojnë në "vetëvrasje" qelizat e sëmura. Për të evidentuar efektin antikancer të kësaj substance natyrore që gjendet në birrë, çikore, arrën e kokosit dhe kafe, janë angazhuar dy epike kërkimore në Universitetin e Urbinos "Carlo Bo". Zbulimi u publikua në "British Journal of Cancer" dhe në "Journal of Organic Chemistry".



Një substancë të padëmshme - Mirco Fanelli dhe Vieri Fusi, në krye të grupeve kërkimore që kanë bashkëpunuar në këtë studim, kanë shpjeguar se molekula maltol është e padëmshme, përdoret nganjëherë si një shtesë ushqimore për shkak të aromës së saj dhe vetive antioksiduese, por nëse modifikohet mund të japë jetë molekulave të reja me prejardhje biologjike. Testet laboratorike - Dy molekula përfaqësuese e kësaj klase të komponimeve, janë sintetizuar dhe të karakterizuar në aftësinë e tyre për të nxitur ndry-

shime në chromatinë dhe, kështu për të udhëhequr qelizat për t'u përgjigjur në terma biologjike.

Kjo klasë e komponimeve ka në bazë vetitë fiziko-kimike që i bëjnë ato të jenë në gjendje të arrijnë në brendësi të qelizave të cilat përmbushin funksionet e tyre në përthamë, ku gjendet edhe genomi (kështu që edhe chromatinë). Fanelli dhe Fusi kanë treguar që disa variante të tumorit (në kulturat qelizore in vitro) janë të ndjeshme ndaj trajtimit me dy molekula (të quajtura maltol dhe maltonis).

studimi

Sport në fëmijëri, mendje të freskët pas të 50-ave

Gjenerata topolake, ç'sport të zgjidhni për të vegjëlit

Kush merret me sport rregullisht, që në fëmijëri, ka një kujtesë, vëmendje dhe aftësi të të mësuarit më të mira edhe pas të 50-ave vjet. Ky është rezultati i një studimi të kryer nga London King's College dhe është publikuar në "Psychological Medicine". Dhe sa më e qëndrueshme të jetë aktiviteti fizik, dhe sa më shumë intesitet, ndihmon në përmirësimin e aftësitë njohëse dhe nuk është kurrë tepër vonë për të filluar dhe për të siguruar një kujtesë më të mirë në moshën e vjetër.

EFEKTET AFATGJATA

Bëhët fjalë për një nga studimet e para për të matur efektet e ushtrimit, mbi trurin e njeriut në afat të gjatë. Sondazhi, ka bërë një lidhje mes tipit dhe nivelit të aktivitetit fizik dhe aftësi njohëse, tek 9 mijë persona, të moshës nga 11 deri në 50 vjeç. Alex Dregan, koordinator i studimit, ka thënë: "Ata që janë stërvitur çdo javë që kur ishin fëmijë dhe të rritur, në moshën 50 vjeçare tregojnë rezultate më të mira në testet e kujtesës, mësimet dhe arsyetimet se sa ata të cilët, megjithatë, bëjnë ushtrime sportive dy ose tri herë në muaj ose më pak".

"Nuk është kurrë shumë vonë". Shkencëtari ka nënvizuar se: "Për ruajtjen e aftësi njohëse në moshën e vjetër është e rekomanduar që për të rriturit, të moshës 19-64 vjeç, të bëjnë të paktën 150 minuta në javë aktivitet fizik, por jo të gjithë mund bëjnë këtë. Përfitimet e trurit jmund të arrihen edhe me një frekuencë më të ulët të aktivitetit sportiv, dhe, edhe ata që nuk janë marrë kurrë me sport mund të fillojnë ta planifikojnë pas stërvitje, pak nga pak, gradualisht duke rritur intensitetin dhe frekuencën në mënyrë që të garantojë një mendje të hekur për të ardhmen".

GJENERATA TOPOLAKE

Fëmijët e sotëm quhen ndryshe edhe gjenerata topolake, pasi gjithnjë e më pak po merren me sport dhe gjithnjë e më shumë ata po bëhen obezë. Ndaj specialistët u rekomandojnë prindërve që të stimulojnë aplimin e një sporti për fëmijët tuaj është shumë e rëndësishme pasi sot më shumë se kurrë rastet për të lëvizur janë të limituara. Pediatrët kanë kohë që flasin që është shumë e rëndësishme dhënia rëndësi sportit të caktuar, për të evituar në këtë mënyrë mbipeshën. Për çdo strukturë fizike të fëmijëve ekziston një sport i cili e bën më të fort dhe të shkathët. Shpesh janë të nevojshëm për të kaluar probleme të mundshme mes bashkëmoshatarëve të tyre.

Nëse është mbipeshë: Sporti më i këshillueshëm është noti, pasi fëmija në ujë ndjehet më i lehtë dhe bën një numër më të madh ushtrimesh, përveçse kursit të notit. Për fëmijët që nuk pëlqejnë pishinamund të synoni për tenis, i cili është një aktivitet sportiv që të dhuron koordinatë ekzakte dhe



praktikohet pa qenë e nevojshme të vraposh shumë.

Nëse i ka shpatullat e ngushta: Nëse fëmija juaj i ka shpatullat e ngushta e ardhur nga një rritje akoma jo komplete, përpara këtij stadi mund ti krijoni probleme. Atëherë për këtë tip fëmije mund

tju rekomandohet tenisi, volejboli të cilët e ndihmojnë fëmijën të zhvillojë muskujt e sipërm.

Nëse ka një qëndrim jo të mirë: Shumë fëmijë në shkollë fillore marrin një qëndrim të gabuar si pasojë e uljes në banka dhe në shtëpi. Ky devijim anësori i kolonës

vertebrale që ka një formë tipike të gurmës "S" mund të modifikohet deri tek fëmijët e moshës 10-12 vjeç. Për këtë qëllim indikohen sportet e cilët stimulojnë pjesën dorsale si noti, basketbolli, volejboli, ndërsa nuk rekomandohen tenisi pasi është sport asimetric.

Studimi

Uji i ngrohtë është më mirë se i ftohti për djegiet

Ekspozimi afatgjatë zonave të djegura të trupit në ujë të ftohtë e ul për një kohë të gjatë dëmton shumë indet e lëkurës, për këtë arsye mjekët këshillojnë të përdoret e ujë të ngrohtë për djegie. Lëshimi i ujit të ftohtë nga rubineti nëpër djegiet e vogla është mënyrë përgjithësisht e njohur e trajtimit të djegieve, por shkencëtarët zviceranë pohojnë që është më mirë të bëjmë të kundërtën dhe ta lëshojmë ujin e nxehtë në pjesën e djegur, shkruan "Fox News". Studimi i Spitalit Universitar Basel ka treguar që uji i nxehtë reduktion dëmtimin e indit dhe ndihmon në krijimin e qarkullimit normal në pjesët e djegura. Pas induksionit të djegieve, brenda 24 orëve nga lëndimi të djegiet identike që janë trajtuar me ujë të nxehtë indi është dëmtuar edhe më pak, ndërsa lëndimet kanë qenë më sipërfaqësore. "Edhe pse uji i ftohtë ndihmon në reduktimin e ndjenjës së dhimbjes, sepse ftoh lëkurën dhe mbarsat nervore, pas 20 minutash rezultojnë të kesh dhimbje sepse ka zvogëluar

temperaturën e lëkurës në temperaturë shumë të ulët", - ka thënë Reto Eetstein, udhëheqës i studimit. Ai sugjeron që menjëherë pas djegies të lëshohet uji i ftohtë në ind, por vetëm një minutë, dhe pastaj të ndryshohet në ujë të nx-

ehet për t'u nxitur qarkullimi. Kur flitet për ujë të nxehtë mendohet për ujin në temperaturën prej 20 deri 30 gradë celsius. Prandaj këshilla e mjekëve është që uji i ftohtë të përdoret, por vetëm për një minutë dhe jo më shumë

Hulumtimi

Ja sa zgjat orari javor i nënës

Sa në të vërtetë punojnë nënën të cilat janë njëkohësisht edhe të punësuar, është pyetje në të cilën ky artikull ofron përgjigjen. Dita e punës e femrave dhe nënave ngadalë po shndërrohet në ankh të pafund, të paktën kështu mund të lexohet në rezultatet e hulumtimit të kryer në kohën e fundit. Kështu, përveç orarit të plot të punës, nënat kalojnë 28 orë shtesë në javë duke u kujdesur për familjen, çka do të thotë që mesatarja e ditës së punës së nënës së punësuar është 13 orë. Tri të katërtat e nënave për shkak të orarit të tillë shumë rrallë



kanë rast të ulen dhe të hanë kafjallin ose darkën në qetësi, ndërsa pushimin e vetëm në parim e

Aktiviteti fizik sipas moshës

■ 2-5 vjeç

Për fëmijët që sapo kanë nisur të ecin dhe ata që shkojnë në arsimin parashkollor, mund të bëhen disa lëvizje dhe ushtrime sportive, por nuk është e përshtatshme që ata të aktivizohen nëpër sporte të ndryshme, pasi moshë është ende e vogël. Më e mira për ta, është liria në veprimet e tyre. Ata mund të lejohen të luajnë, të vrapojnë, të notojnë të shokëruar, të hipin në biçikletë etj, por që pranë tyre duhet të jetë edhe një familjar.

■ 6-7 vjeç

Me rritjen e fëmijëve, edhe përqendrimi i tyre ndryshon. Ata bëhen më bashkëpunues dhe më bindës ndaj atyre që ju kërkon. Për këtë, në këtë moshë mund tu sugjerohen këto lloje sportesh: basketboll, futboll, gjimnastikë, not, tenis, golf, atletizëm, etj.

■ 8 vjeç

Fëmijët e kësaj moshe, mund të angazhohen në të gjitha llojet e sportit. Në këtë moshë, mund të fillohet edhe me sportet e vështira që paraqesin përballje fizike



kanë në vikend kur burrat gjejnë kohë ose vullnet për të ndihmuar në shtëpi ose rreth fëmijëve. Për shembull, rreth 8.5 orë në javë i shpenzojnë duke argëtur fëmijët, derisa në gatim dhe përgatitje të ushqimit shkojnë pesë orë në javë, kurse pastrimi i shtëpisë zgjatet në 3 orë e 38 minuta. Krobat dhe enët marrin dy orë në javë, 60 sa edhe blerja e ushqimeve, ndërsa rregullimi i dhomës një orë e 27 minuta, derisa vetëm dy minuta më pak shkojnë në ndihmën për të bërë detyra të shtëpisë. Kur mbledhen të gjitha, përbëi 60 për qind e nënave kanë aq shumë punë saqë sistemin e imunitetit e kanë seriozisht të rrezikuar.

Kultura e të ushqyerit

Luleshtrydhja, fruti që zgjat jetën e trurit

E pasur me flavonoide, lufton kancerin

Ngryra e kuqe, aroma e mrekullueshme dhe shija e veçantë bëjnë që luleshtrydhjet të jenë frutat më të pëlqyera jo vetëm të fëmijëve, por edhe të të rriturve. Janë një mijë e një arsye se përse nuk duhet t'i ndajmë kurrë nga tavolina. Në mjekësinë popullore luleshtrydhja është ilaçi që mund të shërojë më shumë sëmundje dhe të përdoret kudo. Ata mbahen si një nga ushqimet me përmbajtje më të lartë të vitaminë C. Po ashtu ajo ka dhe vlera të larta mjekësore duke veçuar këtu vetinë e saj të madhe antioksiduese. Mendohet se sa më shumë të skuqet fruti, aq më shumë atij i rriten vlerat antioksiduese. Po ashtu luleshtrydhja ka

Një kërkim shkencor në SHBA e ka cilësuar luleshtrydhen si një frut të çmuar për ruajtjen e aftësisë njohëse të trurit, sidomos atij të femrave. Sipas studimit meritat janë të flavonoideve. Falë këtyre përbërësve, luleshtrydhet janë ushqimi ideal për të mbajtur trurin në formë të mirë

veti mbrojtëse ndaj radikaleve të lira, të cilat shkaktojnë lloje të ndryshme kanceresh. Përveç vitaminë C, ky frut është një burim i mrekullueshëm acidi folik, magnezi, potasiumi, vitaminë B5 dhe B6, magnezi, roflavine, acidit vajor omega-3, vitaminë K dhe bakri. Ato luftojnë kancerin, ulin rrezikun e infeksioneve, parandalojnë prekin nga sëmundjet e mëlcisë dhe largojnë dëshirën për të pirë duhan.

Ajo është bimë shumëvjeçare me shije të hidhur në të ëmbël. Në fitoterapi përdoren gjethet, rrënja dhe lulet. Gjethet e reja të kësaj bime janë mjaft të pasura me vitaminë C, me kripën natyrore, e cila bën pastrimin e gjakut. Në shumë vende përdoret si sallatë, sidomos për ata që vuajnë nga anemia. Luleshtrydhja përmban glikozidet e hidhura, insulinën, tainin, vitaminën B, C dhe provitaminën A, shumë minerale, ka përqindje të lartë të kripërave të kaliumit, sidomos në gjethe, karotenoide, proteinë, pektinën, holinën etj. Në rast se konsumatorët e kanë të vështirë në periudha të caktuara që të gjejnë luleshtrydhe në treg, atyre u këshillohet edhe përdorimi i lëngjeve të frutave që me luleshtrydhe por që nuk përmbajnë gaz.

EFKETET CEREBRALE

Një kërkim shkencor në Shtetet



e Bashkuara të Amerikës e ka cilësuar luleshtrydhen si një frut të çmuar për ruajtjen e aftësisë njohëse të trurit, sidomos atij të femrave.

Sipas studimit meritat janë të flavonoideve. Falë këtyre përbërësve, luleshtrydhet janë ushqimi ideal për të mbajtur trurin në formë të mirë. Flavonoidet janë substanca antioksiduese të pranishme në sasi të mëdha të luleshtrydhet. Ato njihen për aftësinë për të ngadalësuar procesin e reduktimit gradual të aftësisë njohëse të trurit, duke

i garantuar atij në këtë mënyrë një jetë më të gjatë. Autorët e studimit janë një ekip mjekësh në "Brigham and Women's Hospital", të cilët këshillojnë konsumimin e luleshtrydheve, krahas frutave të tjera të pyllit, për të zgjatur mesatarisht me 2.5 vjet jetën e trurit. Studimi ka nisur në mes të viteve 1970 dhe ka përfshirë më shumë se 120 mijë gra të moshës 30-55 vjeçe, të cilat janë pyetur çdo katër vjet në lidhje me mënyrën e të ushqyerit, stilin e jetës dhe gjendjen shëndetësore. Studimi ka vazhduar deri në vitet 1990, kur mbi

16 mijë gra me moshë mesatare 74 vjeç, u janë nënshtruar testeve të kujtesës çdo dy vjet. Studimi ka çuar në rezultate domethënëse, të cilat janë publikuar në revistën amerikane "Annals of Neurology". Sa më i madh konsumi i luleshtrydheve dhe frutave të pyllit, aq më jetëgjatë dhe cilësor aktiviteti cerebral. Sipas studimit,

meshkujt i gëzojnë në mënyrë më të reduktuar vlerat e luleshtrydhes. Luleshtrydhet njihen prej kohësh për vlerat kuruese në rastet e gastriteve dhe hipertensionit. Tashmë, falë studimit në fjalë, i cili ka zgjatur 40 vjet, mund të thuhet se luleshtrydhet janë aleatet më të mira të femrave në luftën kundër degradimit të truri.

Vese

Kakao mbron nga sëmundjet të ndryshme

Kakaoja mbron nga sëmundjet kardiovaskulare, stimulon neuronet, kuron gjendjen shpirtërore. Ajo ka të gjitha vetitë e çokollatës.

Stimuluese, antidepressive, për çdo nevojë afrodisiaku. Për disa persona nuk ka shumë ndryshime nga një drogë. Kakaoja, mes të gjitha ushqimeve, është burimi më i pasur me "flavanol", substanca biologjikisht aktive, të cilat gjenden tek ushqimet bimore. Për mos i ngatërrojme me flavanole-t e verës, të cilat mungojnë te kakaoja. Ato janë substanca intoksikuese, që gjenden në brendësi të saj,

që mbrojnë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ndihmojnë në mbajtjen hapur të arterieve. Pak kakao mund t'i japë një shtysë kujtesës. Kakaoja, si çaji dhe kafeja, përmban substanca ngacmuese të cilat veprojnë mbi receptorët e sistemit nervor, duke rregulluar efektshmërinë e qelizave. Flavanoli nxit një pjesë të mirë të përgjigjeve të neuroneve, që është reagimi i parë në bazë të fenomeneve shumë të vështira të kujtesës dhe kuptimeve. Kakaoja përmban flavan-3-ols, një përbërës i cili ndihmon në uljen e presionit të gjakut. Përbërësit e kakao njihen si nga antioksidantët më të përqendruar dhe që ju mbrojnë

Përbërësit magjikë të frutit

■ Vitamina K

Luleshtrydhet janë një ushqim i pasur me vitaminë K, e cila i bën kokcat të jenë të forta. Mjekët rekomandojnë që të gjithë njerëzit duhet të konsumojnë çdo ditë të paktën 5 luleshtrydhe

■ Vitamina C

Ata mbahen si një nga ushqimet me përmbajtje më të lartë të vitaminë C. Po ashtu ajo ka dhe vlera të larta mjekësore duke veçuar këtu vetinë e saj të madhe antioksiduese.

■ Përbërësit

Ajo është gjithashtu edhe një burim i mrekullueshëm acidi folik, magnezi, potasiumi, vitaminë B5 dhe B6, magnezi, roflavine, acidit vajor omega-3 dhe bakri

■ Sëmundjet

Ato luftojnë kancerin, ulin rrezikun e infeksioneve, parandalojnë prekin nga sëmundjet e mëlcisë dhe largojnë dëshirën për të pirë duhan

■ Flavonoidet


Flavonoidet janë substanca antioksiduese të pranishme në sasi të mëdha te luleshtrydhet. Ato njihen për aftësinë për të ngadalësuar procesin e reduktimit gradual të aftësisë njohëse të trurit

■ Gjethet

Luleshtrydhja përmban edhe glikozidet e hidhura, insulinën, tainin, provitaminën A, shumë minerale, ka përqindje të lartë të kripërave të kaliumit, sidomos në gjethe, karotenoide, proteinë, pektinën, holinën, etj.



realisht nga sëmundjet e zemrës dhe nga kanceri. Po ashtu, mos harroni edhe çokolatën e zezë, e cila ju mbron nga rreziku i vdekjes. Kakao: Të mbron nga sëmundjet kardiovaskulare; Është antidepressive; Bën të mundur uljen e presionit të gjakut; parandalon kancerin dhe zhvillon kujtesën.



retrospektivë

ISH-BRSS DHE SHBA, rezulton t'i kenë bërë disa herë oferta të hapura apo nëpërmjet rrugëve alternative shtetit shqiptar, për të rivendosur marrëdhënie diplomatike

Kur superfuqitë kërkonin riafrimin me Shqipërinë

Hoxha madje refuzoi 36 milionë dollarë ose "arin e luftës" që SHBA dhe Britania ofroi për të pasur sërish një ambasadë në Tiranë

TIRANE
ARMAND PLAKA

Vetëm të të shkonte ndërmend të vendosje (apo rivendosje në fakt) marrëdhënie diplomatike me ta, përbënte një temë tabu edhe për nivelet më të larta shtetërore apo diplomatike në vend, në një kohë kur "gabimet" të kushtonin edhe kokën. Madje, çmenduria shkonte deri atje sa edhe nëse shorti nëpër aktivitete të ndryshme sportive, të bënte të ndesheshe me një sportist apo ekip sovjetik, ose amerikan, bojkotimi i aktivitetit apo tërheqja nga gara, konsiderohej normale dhe mëse e sigurt për shqiptarët. Nga ana tjetër, pakush mund të mendojë edhe sot e kësaj dite se BRSS apo SHBA, do të mund të kishin shfaqur interes apo do të mund të "ulnin kokën" e të ndërmerin iniciativa për afrim apo normalizim marrëdhëniesh me Shqipërinë e Enver Hoxhës, për sa kohë që kjo e fundit sillte si "fëmija plangprishës" në shumë aspekte, duke vazhduar të shante, "demaskonte" e të akuzonte me tone të larta në çdo rast që i jepej, dy fuqitë më të mëdha të kohës. Mirëpo, SHBA dhe BRSS, shpesh dhe në mënyrë (jo domosdoshmërisht) paralele, siç rezultoi edhe nga materialet në vijim, po punonin për t' u afruar me Shqipërinë e Hoxhës, për të harruar "mëritë e vjetra" e rinisur një erë të re, sado që mund të duket e vështirë. Sigurisht se nuk është rasti të diskutojmë këtu për interesat apo kalkulimet që "armiqitë ideologjikë" në të dyja krahet bënin për të ndërmarrë këtë hap. Synimi është thjesht nxjerrja në pah e fakteve me vlera historike e arkivore, të cilat dëshmojnë, le të themi, për dëshirën e tyre për t' u pajtuar me Shqipërinë, edhe nëse ajo vijonte të ishte ashtu sikurse edhe më parë, po aq antagonist e armiqësore në qëndrimet e saj ndaj tyre. Gjithsesi, vihet re se në momentin që ata shihnin lëvizjen më të vogël në drejtimin e vlerësuar të vulltshëm prej tyre, ata "hidheshin në sulm" për të përfutur sa më parë frutet e një ndërmarrje të tillë politiko-diplomatike, duke dërguar sinjalet përkatëse. Kjo, me fjalë të tjera, dëshmon edhe për interesin (sado që shkalla e tij mbetet shumë e diskutueshme) e jo për të kundërtën, nga ana e dy superfuqive ndaj Shqipërisë, siç mund të ketë pretenduar shumëkush, edhe sot e kësaj dite. Sidoqoftë, fatkeqësisht, në çdo rast ofertat nuk rezultojnë të jenë marrë parasysh nga qeveria e kohës e të jenë studiuar me gjak të ftohtë nga diplomatët e saj, për të parë përfitimet e mundshme, të cilat do ishin, sigurisht, relevante, sidomos në çaste lëkundjesh të forta politike, që mund të çonin teorikisht edhe në vetë rrëzimin e regjimit të Hoxhës.

OFERTA TË SHPESHTA SOVJETIKE
Të paktën, nga ish-Bashkimi Sovjetik hasim në disa përpjekje përafëruese apo oferta konkrete për të rivendosur marrëdhëniet me Shqipërinë, sigurisht pas splotimit të Hrushovit nga posti që mbante dhe ardhjes në pushtet të Brezhnjev-it apo pasardhësve të tij. Kështu, në një numër



Kremlini në ditët e sotme

të gazetës gjermane "Die Zeit" të vitit 1966, shprehimisht në lidhje me një nga këto oferta, shkruhet e zeza mbi të bardhë se: Kremlini i ka ofruar Shqipërisë, mikun e vetëm në Pekin në Europë, rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, që u ndërpreu që nga viti 1961. Në të njëjtën kohë, Partia Komuniste e Shqipërisë u ftua të marrë pjesë në Kongresin e 23-të të Partisë Komuniste (bolshevike), në fund të marsit në Moskë. Objektivi Sovjetik është i qartë: Shqipëria duhet të hiqet nga sfera e

ndikimit të Pekinit. Për Moskën, shanset nuk janë të këqija. Gjendja ekonomike e vendit të vogël ballkanik është katastrofale. Plani i fundit pesëvjeçar nuk mundi dot të realizohet as me ndihmën e Kinës. (Shih: ZEITSPIEGEL, Gazeta "Zeit", 18.02.1966 / Nr. 08)

MOSKA NË 1976: SHQIPTARËT, POPULL "VËLLA"

Më tej në artikull shprehet shpresa se: Ka shumë shenja që të bëjnë të mendosh se Tirana është gati të përfundojë me Moskën dhe fqinjët e saj komuniste një akord paqeje. Ajo tashmë ka nënshkruar një marrëveshje tregtie me Rumaninë, ka nënshkruar marrëveshje kulturore me Hungarinë, Bullgarinë dhe Jugosllavinë, dhe ka këmbëz përsëri ambasadorët me Poloninë. (Shih po aty). Pothuajse 10 vjet më vonë, Kremlini zyrtar duket se i rikthehet sërish gështjes së marrëdhënieve me Shqipërinë, duke tentuar ta joshë, siç dëshmon në vitin 1976, revista e mirënjohur gjermane "Der Spiegel". Me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Shqipërisë, më 11 Janar 1976, Moskë zyrtare i cillei shqiptarët sërish si "popull vëlla" pavarësisht se Shqipëria nën drejtimin e Sekretarit të Partisë së saj komuniste, Enver Hoxhës, i ka ndërprerë marrëdhëniet me BRSS qysh në vitin 1960, ka dalë ndërkohë edhe nga Traktati i Varshavës e tashmë qëndron plotësisht në krah të Kinës. BRSS ka ofruar me këtë rast edhe

Propozimet miqësore

Tirana, goditje 'revolucionare' Lindjes dhe Perëndimit

Kështu, në po të njëjtën gazetë, por tashmë pas disa viteve (në vitin 1983) thuhet se: S' ka shumë kohë që Shqipëria akuzoi shefin e ri të Kremlinit, Andropov, se "po përdor gjuhën e një diktatori fashist". Propozimeve të Andropov-it për afrim dhe rivendosje të marrëdhënieve diplomatike, shteti i vogël nacionalkomunist i Ballkanit u dha një goditje ironike. Shqiptarët po ashtu, mësohet se do të refuzojnë edhe 36 milionë dollarët në vlerë ari, të cilat së fundmi ia kanë ofruar amerikanët, anglezët dhe francezët – me synim normalizimin e marrëdhënieve dhe si dëmshpërblim për thesarin shqiptar, i cili u zhvendos drejt Londrës, në përfundim të Luftës së Dytë. (Shih: Ein Held und viele Schurken; Gazeta "Zeit", 14.01.1983/Nr.03). Në vazhdim e kësaj logjike, gazeta në fjalë, më tej na ofron një artikull të gjatë, i cili lidhet me momentin e vrasjes së Mehmet Shehut, duke u munduar të analizojë shkaqet e të nxjerrë në pah detaje tresh saj, por që hasin më së shumti në terrin informativ të ofruar nga realiteti i asaj kohe në Shqipëri. Në krye, artikullshkruesi thekson faktin se Tirana zyrtare ka hedhur edhe një hap tjetër fatal që e çon atë të zhytet edhe më tej në izolim nga bota e jashtme.



NË FOTO: Tirana e viteve '70 (foto ilustruese)

"rivendosjen e miqësisë e të bashkëpunimit" – ndërkohë që Hoxha, përkundrazi, para pak kohësh ka deklaruar se ka ndërmend të bëjë publik (në vitin 1980) protokollin e plotë të takimeve të fundit që ka pasur me Kremlinin, para se marrëdhëniet të merrnin fund. Ato tentojnë të sjellin një këndvështrim të rrallë mbi sjelljet e liderëve komunistë në përballje me njëri-tjetrin dhe të bëjnë më të qarta rrethanat, në të cilat Moskë u detyrua të humbasë një aleat të bindur të saj – si dhe një bazë navale në Mesdhe. (Shih: Chruschtschoë: Sie haben mich bespuckt; Revista "Spiegel" Nr. 7., 09.02.1976, fq. 84-91)

OFERTAT AMERIKANE, TË HERSHME

Mirëpo asnjë nga këto përpjekje nuk rezultoi të kishte sukses. Por më parë, iniciativa më pozitive dukej se vinin për Tiranën komuniste nga një drejtim tjetër, dhe pikërisht nga SHBA. Qysh në vitin e largët 1957, sipas të njëjtit burim, na vjen një lajm në dukje sensacional edhe për vetë historianët, ku shkruhej se: Departamenti Amerikan i Shtetit dëshiron të përmirësojë marrëdhëniet me Europën Lindore, në mënyrë që të mbështesë e motivojë më shumë lëvizjet komuniste me karakter nacionalist ndër shtetet satelite të Moskës. Kufizimet për udhëtime drejt Bullgarisë sapo janë hequr, dhe shumë shpejt shtetasit amerikanë do të mund të udhëtojnë edhe drejt Shqipërisë. Departamenti i Shtetit po përgatit më terma më afatgjatë, të rivendosë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, të cilat u ndërpreu në vitin 1946. Ndërkohë, edhe në republikat sovjetike: Bjellorusi dhe Ukrainë, ky Departament ka ndërmend madje, të dërgojë përfaqësues diplomatikë.

Ajo që duket akoma më interesante në gjithë këtë histori, është fakti se në këtë kohë, Tirana ishte në kulmin e miqësisë me sovjetikët, e nuk kishte pse të ngjalle aq interes, paqsa se përplasjet ideologjike me udhëheqjen e re sovjetike, nën rrogos kishin filluar me kohë. Duket se Departamenti Amerikan i Shtetit, kishte nuhatur me kohë



Faksimile e artikullit në revistën gjermane "Der Spiegel", 09.02.1976, fq. 84

Faksimile e artikullit në revistën gjermane "Die Zeit", 18.02.1966/ Nr. 08 fq. 2

TË VËRTETËN mbi vdekjen e Shehut e di vetëm udhëheqja shqiptare. Por e sigurt është se mënjanimi i këtij të fundit, nxori në skenë sërish një valë të re spastrimesh

TABLOJA SINOPTIKE

Ja si politika mund të deformatë historinë

Gjithashtu, në fund të artikullit, gazeta në fjalë sjell për lexuesit e vet, pjesë nga e ashtuquajtura "tablo sinoptike" rreth veprës agenturore të ish-krumministrit Mehmet Shehu, marrë nga libri (asokohe i sapodalë në qarkullim) i diktatorit Hoxha "Titistët", nga ku, siç shkruan gazeta gjermanoperëndimore ("Die Zeit", 14.01.1983 Nr. 03) del se: duke i lexuar ato, përfton një ide më të qartë mbi metodat staliniste, me të cilat bëhet politika edhe sot e kësaj dite në Shqipëri, duke tentuar të deformatë edhe vetë historinë. Meqenëse kjo përmbajtje (dmth tabloja sinoptike dhe pikëpamjet e Hoxhës rreth Shehut pas vrasjes apo vetëvrasjes së këtij të fundit) për shqiptarët tashmë janë të njohura me kohë, unë nuk po i botoj ato, duke sjellë në vëmendje të lexuesit vetëm pasazhet nga artikulli që do të na interesonin: Vendi i vogël mesdhetar me pozitën e tij të rëndësishme strategjike, duket se i ka shkëputur sërish të gjitha lidhjet që të çojnë në botën e jashtme. Pika e kthesës për të marrë këtë vendim duket se ka qenë 17 dhjetori 1981. Në këtë ditë, kryeministri 68-vjeçar, Mehmet Shehu, ka kryer vetëvrasjen. Shumë shpejt pas ndodhës qarkullonin thashetheme që vinin nga Jugosllavia, se në Byronë politike shqiptare kishte pasur këmbime zjarri mes shefit të Partisë, Enver Hoxha dhe Shehut. Të vërtetën mbi vdekjen e Shehut e di vetëm udhëheqja shqiptare. Por e sigurt është se mënjanimi i këtij të fundit, nxori në skenë sërish një valë të re spastrimesh, e cila u shpërthye gjithë vitit 1982, e që duket se vetëm tashmë po njih fundin e saj, duke sjellë me vete zhvendosjet dhe nxjerrjen në pah si asnjëherë tjetër, aferat vrastare dhe luftët më të ashpër për pushtet në historinë shqiptare të pasluftës. Duetit mes Hoxhës dhe Shehut, të cilit në sfond duket se i ishte ngjeshur përplasja për t'a orientuar Shqipërinë drejt Perëndimit (të cilën mendohet se e përfaqësonte Shehu), por që në të vërtetë u bë për të mënjnuar trashëgimtarin e drejtpërdrejtë të 74-vjeçarit Hoxha, thuajse i ra viktimitë i gjithë kabineti qeveritar. Pas Shehut, u rreza nipi i tij, Feqor Shehu, në postin e Ministrit të Brendshëm. Atë e ndoqën më pas Ministri i Mbrojtjes, Kadri Hazbiu (kunati i Shehut) dhe Ministri i Jashtëm, Nesti Nase. Edhe shefit të shtetit, Haxhi Lleshi, u desh ta linte postin e tij që e mbante prej 30 vjetësh, në favor të "Princit" të ri të kurorës, që do të pasojë Hoxhën, Ramiz Alia. Po kështu, goditje morën edhe ministrat e tregtisë me jashtë, ekonomisë, ndërtimit, industrisë e minierave, industrisë së lehtë e asaj ushqimore.



Mehmet Shehu natën e 17 dhjetorit 1981

Mbi fatin e vartësve të Shehut nuk ka asnjë informacion. Por historia e pasluftës së Shqipërisë, nuk të lë të mendosh gjatë se ata mund t'ia kenë hedhur me ndonjë pasojë të vogël. Në vitin 1948, Hoxha dhe Shehu së bashku rrëzuan përkrahësin e Titos, Koçi Xoxe dhe e ekzekutuar. Mbështetësit e Hrushovit, Liri Belishova dhe Koço Tashko, u rrëzuan në vitin 1961, dhe me shumë gjasa, janë ekzekutuar. (Tirana pretendon se ata jetojnë akoma dhe janë në pension). Në vitin 1973, funksionarët e lartë të sektorit të Kulturës, Pacrami dhe Lubonja gjithashtu u rrëzuan, dhe ata u bënë asokohe viktimat të një fushate tjetër distancimi nga normat perëndimore. Në vitin 1974, Ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku dhe ish-zyrtarë të lartë ushtarakë u ekzekutuan për shkak të pretendimit se po flirtonin e thurnin plane me kinezët, jugosllavët dhe rumunët. Në fund të valës së fundmit të spastrimeve, shefi 74-vjeçar i partisë bëri publik edhe versionin e vet mbi fundin tragjik të Mehmet Shehut. Në librin e tij të sapodalë në treg në libraritë e Tiranës, me emrin "Titistët", Hoxha "zbulon" se ish-shefi i kabinetit të shtetit të udhëhequr prej tij, paskësh qenë një agjent i hershëm i CIA-s dhe i shërbimit të fshehtë jupor që në të vërtetë u bë për të mënjnuar trashëgimtarin e drejtpërdrejtë të 74-vjeçarit Hoxha, thuajse i ra viktimitë i gjithë kabineti qeveritar. Pas Shehut, u rreza nipi i tij, Feqor Shehu, në postin e Ministrit të Brendshëm. Atë e ndoqën më pas Ministri i Mbrojtjes, Kadri Hazbiu (kunati i Shehut) dhe Ministri i Jashtëm, Nesti Nase. Edhe shefit të shtetit, Haxhi Lleshi, u desh ta linte postin e tij që e mbante prej 30 vjetësh, në favor të "Princit" të ri të kurorës, që do të pasojë Hoxhën, Ramiz Alia. Po kështu, goditje morën edhe ministrat e tregtisë me jashtë, ekonomisë, ndërtimit, industrisë e minierave, industrisë së lehtë e asaj ushqimore.

Thuajse i tërë aparati shtetëror, paskëshin qenë kundra kursit të tij. Kjo të bën të kuptosh se çfarë lufte për pushtet e pret pasuesin e dënuar të Hoxhës...

gossllav, UDB. Gazeta "DIE ZEIT", me këtë rast po boton edhe pjesë të shkëputura të pikëpamjeve të Hoxhës, përka i përket kësaj çështje, pasi duke i lexuar ato, përfton një ide më të qartë mbi metodat staliniste, me të cilën bëhet politika edhe sot e kësaj dite në Shqipëri, duke tentuar të deformatë edhe vetë historinë. Sa më i anshëm paraqitet përkrahimi i ngjarjeve dhe përfundimet që nxjerr vetë Hoxha, aq më qartë del në pah se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Hoxha përmend vetëm Partinë dhe popullin si shpëtimtarë. Me fjalë të tjera: Qeveria, Ministria e Brendshme dhe thuajse i tërë aparati shtetëror, paskëshin qenë kundra kursit të tij. Kjo të bën të kuptosh se çfarë lufte për pushtet e pret pasuesin e dënuar të Hoxhës, Ramiz Alia, kur diktatori aktual, tashmë 74-vjeçar, të lërë pushtetin.

se ç' bëhej dhe ndoshta ushqente shpresën e vakët se Tirana do të bindej për t' u afruar e rivendosur edhe një herë marrëdhëniet me Uashingtonin, në mënyrë që Enver Hoxha të mund të ruante pozitën e tij, tashmë si një komunist nacionalist (e jo më si një proletar internacionalist) ë guxon të kundërshtojë Moskën, çka i shkente për shtat politikave që inkurajojnte SHBA, siç kishte bërë dikur me Jugosllavinë. Projekti, sipas asaj çka hasim në rreshtat e medias gjermane në fjalë, kishte gjasa të vihej në jetë pra, pas disa apo shumë vitesh, pasi aty thuhet se po punohej "në terma afatgjatë". Sidoqoftë, kjo do të vinte pas një pune intensive e negociatash të vështira në këtë drejtim, të cilat duket se kanë vijuar vetëm në një kahje, atë amerikane, pra praktikisht nuk rezultoi të jenë zhvilluar kurrë. Me gjithë dështimet, raportime të rralla hasheshin tek-tuk në mediat perëndimore edhe gjatë viteve '70, për bisedime të fshehta, shpresa për normalizim marrëdhëniesh apo

oferta lindore e perëndimore për regjimin e Hoxhës. Vjena, Beogradi, apo dhe ndonjë vend tjetër, rezultoi të kenë qenë mëse një herë vendtakime për bisedime "underground", që nuk sollën asnjëherë rezultate.

FILLIMVITET '80, LËVIZJE TË PAPANASHIKUARA

Në rëkohë, me fillimin e viteve '80, lëvizje të befta e të paparashikuara tronditën papritur këtë realitet. Nisja e demonstratave në Kosovë dhe marrja fund e një të ashtuquajtur "muaj mjalti" mes Jugosllavisë e RPSSH-së, dhe në fund shpërthimi i valës më të ashpër të spastrimeve që historia e pasluftës në Shqipëri kishte njohur ndonjëherë në nivelin e saj më të larta shtetërore e qeverisëse, bënë që ofertat e ripërsëritura për rivendosje marrëdhëniesh me shtetet perëndimore e gjithashtu edhe me Moskën, të bëheshin nul e të hidheshin për të disatën herë në koshin e plehrave.



shumë, ndërsa shkruante se Shqipëria qenqësh e izoluar, duke i kujtuar autorit se ai qenqësh i paaktualizuar në informacione, ndërsa përmendeshin hapat e fundmit të Tiranës zyrtare për vendosje marrëdhëniesh me vende si Suedia apo Zvicra, apo edhe rishikimi me kahje pozitive i politikave me fqinjët. (Shih: Albanien im Wandel; Gazeta "Zeit", 20.11.1970 / Nr. 47)

Vitet '70

Epokë ndryshimesh jo vetëm kozmetike

Vitet '70, në shumë aspekte nisën të flasin për një zgjerim të marrëdhëniesh diplomatike dhe tregtisë me jashtë, dhe u duk sikur tashmë Shqipëria ndoshta po e ridimensiononte politikën e saj drejt hapjes së mëtejshme me Perëndimin, por edhe drejt ish-vendeve të Bllokut të Demokracive Popullore, dikur të trajtuar si vëllezër". Madje, në këtë kohë, në një kritikë të bërë po në këto media të mirënjohura gjermanoperëndimore, pas botimit të një libri me informacione rreth Shqipërisë, shkruhej se: autori duhej të thellohej më

Homazh

REGJISORI Koço: *Ideja më lindi para dy vitesh, frymëzuar nga epitafi që shkrimtari, Skënder Rusi ka lënë tek varri i tij, "Një ditë do të kthehem dhe do t'ju them ishte shaka"...*



NË FOTO: Aleko Prodan pak minuta para se të vdiste në skenë, dhe gjatë momentit tragjik, ndërsa i afrohen kolegët për ti dhënë ndihmën e parë. Fotot janë marrë ditën e ndarjes nga jeta të aktorit të madh, në orën 19:30 të datës 2 maj 2006, kur ai po luante rolin e fundit në premierën "Tri gra për një burrë" të Dario Fo-së.



In memoriam

Homazh për Agim Qirjaqin

Në trevjetorin e ndarjes nga jeta



NGA KIÇO LONDO

Ka pak njerëz që zotërojnë një talent superior, jo vetëm në profesion, por edhe në shpirt. Një nga këta ka qënë artisti i shquar Agim Qirjaqi.

Të jesh student, pastaj regjisor dhe mik i një njeriu të tillë është një shans që jo të gjithë mund ta kenë. Unë e pata atë shans.

I dashur profesor! Të jam mirënjohës për mundësinë e artë që më dhe për t'u bërë pjesë e suksesit tuaj.

Ju ishin nga ata aktorë që nuk pranonin një sukses të zbehtë. Ju ndiqnin dhe tek të gjithë ne që ju rrethonim, projektohej drita juaj. Ju nuk pranonin të ishit asnjëherë figurant, as në kohën kur shtrohej dilema "të jetë a të mos jetë Teatri Kombëtar". Ju në atë kohë ishit një protagonist i guximshëm, por ndryshe nga skena ku ne shikonim përmasat gjigante të talentit tuaj, aty ju shfaqët epërsinë e karakterit tuaj.

Meritat dhe kontributin tuaj të pagmuar historia do ta marrë dhe do ta vendos në tempullin e lavdisë. Ata që ju kanë njohur nga afër sot, në këtë përvjetor do të donin të thonin shumë për ju.

I dashur profesor. Ju tani jeni bërë qiejlor, por jehona e duartrokitjeve tona për ju do të mbërrijë gjithmonë aty lart.

ALEKO PRODANI

Një premierë frymëzuar nga epitafi i varrit të tij

"Ju thashë që ishte shaka"..., me regji nga Guri Koço

KORÇE

DAFINA ISMALI

Ju thashë që ishte shaka"... Frymëzuar nga epitafi në varrin e aktorit të madh të humorit Aleko Prodan, kjo frazë do të mbledhë këtë fundjavë artëdashës të shumtë në tetarin "Andon Zako Çajupi" në Korçë. Pikërisht këtë titull i kanë vendosur premierës së kësaj fundjave, e cila do të jetë një përkujtim dhe nderim për aktorin e mirënjohur Prodan.

Me regji të Guri Koços, scenografi të Beqo Nanajt dhe koreografi të Bardhi Pojanit, premiera sjell së bashku pjesë të ndryshme teatrale të interpretuara me mjeshhtëri nga aktori, Prodan, por që tashmë do të luhen nga kolegët e tij. Probleme të mprehta sociale vinë për artëdashësit korçar nën prizmin e humorit. Është një vepër e cila i kushtohet tërësisht aktorit të mirënjohur Aleko Prodan, i cili prej vitesh nuk jeton më, por sigurisht që është pranë nesh me veprat, rolet dhe karakteret e krijuara prej tij.

Vepër është shkruar dhe vënë në skenë nga, Guri Koço, i cili prej vitesh e ka pasur idenë për të vënë në skenë një vepër për Aleko Prodanin.

Regjisori Koço shprehet se ideja për të vënë në skenë një premierë për aktorin, Aleko Prodan i lindi para dy vitesh, frymëzuar nga epitafi që shkrimtari, Skënder Rusi ka lënë tek varri i tij, "Një ditë do të kthehem dhe do t'ju them ishte shaka".

"Unë kisha së paku të vjet që punoja me të dhe vura rreth 10 vepër me Lekon (Aleko Prodanin). Ishe një nga miqtë e mi më të ngushtë dhe nuk e kam përjetuar kurrë sikur nuk ekziston më. Nëpërmjet kësaj premiere dëshiroja që t'i thurja Lekos një këngë të bukur dhe ja arrita. Mendimi më lindi para dy ngushtës, e testova dhe me kolegë të tjerë dhe thashë: po unë do të bëj një recital

për mikun tim. Në fakt është ideja që ta sjell në skenë, pasi në epitaftin e Lekos, Skënder Rusi shkruan "Një ditë do të kthehem dhe do t'ju them ishte shaka".Premiera mbështetet tek humorit. Materialet humoristike dhe paroditë në qendër do të kenë problemet sociale që ne i prekim në jetën tonë. "E bukura është se janë po ato probleme që kanë qënë dikur dhe që Alekoja i ka trajtuar në materialet e veta, probleme të tilla siç është korrupsioni, lojrat e fatit, të cilat vinë bukur nëpërmjet parodive apo dhe monologjeve", shprehet

drejtoresha e teatrit, Zamira Kita. Premiera "Ju thashë se ishte shaka", ka mbledhur së bashku, jo vetëm trupën e aktorëve korçarë, por dhe aktorë të tjerë të humorit, si Seifulla Myftarin apo Muarem Hoxhën. "Për mua është një kënaqësi, është një respekt që ndodhem në këtë skenë, ku Aleko Prodan ka luajtur për vite e vite me radhë. Të flas për, Alekon do duhen ditë dhe netë pa fund. Është një aktor gjigand i humorit shqiptar, një aktor i pazvëndësueshëm, një aktor që i ka dhënë shumë skenës shqiptare

dhe televizionit. Është një kënaqësi dhe djali i Aleko Prodanit, Albano Prodan, i cili mes lotëve shprehet se ky është një nderi i madh që i bëhet babait të tij, ku pjesë që ai i ka interpretuar i risillen edhe njëherë publikut, po me aq mjeshhtëri. Premiera "Ju thashë që ishte shaka", shfaqet për publikun për tre net rresht me 29, 30 dhe 31 mars.

Peticioni

Kadare kundër ndërhyrjes së Turqisë në histori

Rreth 127 intelektualë shqiptarë nga të gjitha trojet ku banojnë dhe mes tyre edhe shkrimtari i njohur Ismail Kadare kanë hartuar një petition kundër nënshkrimit të historisë nën mbikëqyrjen e autoriteteve turke. Peticioni është firmosur nga shumica e intelektualëve shqiptarë. Organizatorët e kësaj forme proteste janë Ndue Ukaj, Ardian Ndreca, studiuesi arbëresh Matteo Mandala, Lazer Stani dhe Majlinda

"Faktet historike dhe argumentet shkencore janë ngjarje dhe momente jetike në historinë e një kombi. Ato s'mund të ndryshohen me ndërhyrje të jashtme

Bregasi. Pak kohë më parë, Republika e Turqisë ka kërkuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë që librave shkollorë të historisë t'u bëhet një rishikim i kujdesshëm dhe që në pjesë të caktuara të tyre të bëhen edhe korigjimet. Kjo kërkesë është bërë duke pretenduar se është shtrembëruar imazhi i Turqisë në periudhën e pushtimit të Shqipërisë prej saj. Ky petition iu është dërguar Presidentit Nishani dhe Presi-

dentës Jahjaga, po ashtu Parlamentit, qeverisë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës. "Faktet historike dhe argumentet shkencore janë ngjarje dhe momente jetike në historinë e një kombi. Ato s'mund të ndryshohen me ndërhyrje të jashtme. Sidomos ku bëhet fjalë në marrëdhëniet mes një perandorie pushtuese dhe një kombi të pushtuar", shkruhet mes të tjerash në këtë petition. **dhu.ha.**



Intervista

SHKULEN për skrap në qendër të Tiranës pllakat e Monumentit të 100-vjetorit të Pavarësisë. Monumenti u derdh në Austri 4 muaj më parë. Kushtoi 450 mijë euro

Grabitet Monumenti i Pavarësisë

Flet Rubens Shima, drejtori i Galerisë Kombëtare të Arteve: Rrezikohen të gjitha veprat e derdhura në metal. Vetëm njëra nga pllakat kushton 300 euro

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Monumenti i 100-vjetorit të Pavarësisë ka kushtuar rreth 355 mijë euro dhe tashmë nuk dihet se sa do të kushtojë, duke u shitur pjesët e tij për skrap. Rubens Shima, drejtori i Galerisë së Arteve, ka reaguar në intervistën e tij për "Shqiptarja.com" pas lajmit për vjedhjen e pjesëve metalike të Monumentit të Pavarësisë të vendosur në Parkun Rinia në Tiranë. Pjesët metalike nga baza e monumentit janë shkullur, duke dëmtuar jo vetëm monumentin, por edhe sistemin e ndriçimit. Monumenti, i cili është i lartë 6.5 metra dhe 5.5 m i gjerë dhe peshon 15 ton, ka rënë pre e grabitësve të metaleve dhe tashmë disa pjesë të tij mungojnë. Drejtori i Galerisë Kombëtare të Arteve, Rubens Shima thotë se rasti është i rëndë, por "nuk është hera e parë që vidhen vepra arti për skrap". Gjithashtu ai iu bëri apel forcave të Rendit që të mundësojnë gjetjen e pjesëve sepse ribërja e tyre në Austri do të jetë shumë e kushtueshme, ku vetëm njëra nga pllakat, mes katër që mungojnë, kushton 300 euro. Pra bëhet fjalë për një dëm më shumë 1.200 euro duke llogaritur edhe dëmet në sistemin e ndriçimit.

Zoti Shima, cili është reagimi juaj për aktin e grabitjes së monumentit të Pavarësisë?

-Sigurisht që e konsideroj ngjarje të rëndë, shumë shqetësuese. Di që shkullja e pllakave të këtij monumenti nuk është një akt vandalizmi, por një akt i pastër vjedhjeje. Dhe mendoj se është një fillim pozitiv fakti që policia ka ndaluar vjedhësit. Vetëm se në këtë rast unë do të lutesha që ato struktura të policisë që merren me hetimin t'i gjejnë elementët e grabitur të monumentit dhe të mundësojnë kthimin me qëllim që të restaurohet dëmi. Mendoj që të bëhet ç'është e mundur për këtë në rast, nëse pllakat nuk janë shkrirë ende për skrap. Kjo ngjarje më jep shkak t'ju kujtoj se nuk është hera e parë që vidhen vepra arti për skrap. Në këtë rast kemi të bëjmë me njerëz të dëshpëruar, që janë shumë të varfër dhe arrijnë të bëjnë gjithçka vetëm për të fituar ndonjë të ardhur të vogël.

Mendoni se grabitësit e met-



NË FOTO: Monumenti i Pavarësisë, në të cilin katër pllakat janë shkullur dhe zhdukur ditën e hënë dhe dy të tjerat janë bërë gati nga autorët të cilët u kapën dje në flagrancë



Rubens Shima



NË FOTO: Ja si ishte Monumenti ditën e përurimit më 29 Nëntor 2012

aleve për skrap i janë drejtuar monumentit të Pavarësisë, pasi kanë mësuar nga mediat që metali i tij është shumë i shtrenjtë?

-Edhe kjo mund të ketë ndikuar. Por në Shqipëri nuk është hera e parë që veprat e artit grabiten për skrap. Janë grabitur disa skulptura të realizmit socialist të derdhura në metal, të cilat dihet që janë shitur dhe shkrirë për skrap. Monumenti i Pavarësisë është i bërë me aliazh të shtrenjta. Megjithatë, duke qenë në

qendër të Tiranës ishte e vështirë që ta mendoje se do të grabitej. Mund të ketë ndikuar fakti që metali kushton, por unë ju kujtoj se në këtë kohë çdo monument që është i derdhur më material tregu për t'u ricikluar rrezikohet.

Ju thatë se ka mjaft raste të grabitjes dhe shkrirjes së skulpturave të realizmit socialist. Për cilat e kini fjalën konkretisht?

-Po një rast janë herojtë e vigut. Atyre u janë shkëputur gjymtyrët për

skrap. Kemi rastin e skulpturave të Leninit dhe të Stalinit, të cilat arriti t'i shpëtonte Galeria e Arteve dhe megjithatë nga skulptura së Stalinit arritën të shkëputnin një dorë. Rasti i Monumentit të Pavarësisë është Flagrant, por për fat të keq të gjitha monumentet e derdhura në metal janë objektiva sulmesh.

Ju e dini, pak a shumë, vlerën e materialit të gjithë monumentit. Sa kanë kushtuar pllakat e grabitura?

PYETJE PERGJIGJE

Kur dhe pse u krijua vepra?

Monumenti u ngrit për nder të 100-vjetorit të pavarësisë e që u përrua pikërisht më 28 Nëntor 2012

Kush janë autorët e saj?

Arkitekti shqiptar nga Kosova Visar Obrija dhe arkitekti gjerman Kai Roman Kikla

Sa kushtoi Monumenti totalisht?

Fituesit e projektit morën 35 mijë euro. Derdhja kushtoi afër 104.000 euro. E gjithë vepra: 450 mijë euro

Pse kushton materiali?

Ka çelik dhe panele anësore bronzi të presuara me aliazh metalesh të shtrenjta kundër ndryshkut

Pse pati debate për veprën?

Akademikët e quajtën të panvojshëm se gjendet në Vlorë ku ndodhi ngjarja. Diskutime edhe për origjinalitetin

Autorët

Policia arrestoi dje në flagrancë dy 18-vjeçarë

Në orët e vona të ditës së hënë janë shkullur katër pllaka metalike të çmuara nga Monumenti i Pavarësisë në Tiranë. Ndërkohë dy pllaka të tjera janë bërë gati për t'u shkullur nga bazamenti i Monumentit të vendosur në Parkun Rinia në qendër të Tiranës. Në mesditën e djeshme policia nëpërmjet një deklarate për mediat informoi se grabitja ka ndodhur para dy ditësh dhe sot u bë arrestimi i dy personave të dyshuar si autorët të ngjarjes. Ata janë Amarildo Demiri dhe Qemal Mustafa, ndërsa arrestimi u bë i mundur vetëm pas rikthimit të tyre tek monumenti për të vjedhur sërish pjesët e tij. Gjatë marrjes në pyetje ata kanë thënë se pjesët metalike i kanë shitur për skrap dhe prej tyre kanë përfituar 2 mijë lekë të reja. Dy të arrestuarit pllakat i kanë shkëputur duke përdorur sqepar dhe një thikë. Monumenti u ngrit për nder të 100-vjetorit të pavarësisë e që u përrua pikërisht më 28 Nëntor 2012. Pjesët metalike nga baza e monumentit janë shkullur, duke dëmtuar jo vetëm monumentin, por edhe sistemin e ndriçimit.

-Nëse nuk gjenden, nëse janë shkrirë dëmi është shumë i rëndë. Vetëm njëra nga pllakat kushton 300 euro. Pllakat nuk janë të vogla, janë afërisht të përmasave 1.5 metra katrorë.

Por nëse ato janë shkrirë, çdo të bëhet?

-Ministria e Kulturës do t'i dërgojë kompanisë austriake që të bashkëpunojë për derdhjen sërish të tyre.



De Biasi: Norvegjia? Festova sikur Italia fitoi Botërorin

ITALI

Fitoret e fundit të Shqipërisë përballë ekipeve të Norvegjisë dhe Lituanië kanë bërë jehonë edhe jashtë territorit të vendit. Kështu në Itali, rezultatet pozitive janë lidhur ngushtë me trajnerin De Biasi, i cili është padyshim arkitekti i fitoreve. Në një intervistë për mediat italiane De Biasi shpre-

het se fitoren përballë Norvegjisë e përjetoi në të njëjtën mënyrë sikur Italia fitoi kampionatin botëror. "Kur e mora kombëtaren e Shqipërisë të gjithë ishin skeptikë për mënyrën e organizimit, pasi ishte fundi i një epoke dhe fillimi i një tjetre. Jam i kënaqur shumë me punën që kemi bërë deri më tani. Rezultatet që kemi marrë deri tani në eliminatore janë të kënaqshme. Në

Oslo të gjithë ishin mosbesues, por në fund u gëzuan të gjithë pa masë. Madje mund të them që kam festuar në të njëjtën mënyrë sikur festova kur Italia u shpall kampione e Botës. Më pas ndeshja me Lituanië, nuk e prisja që të fitonim 4-1, aq më tepër që po eksperimentoja disa mungesa të rëndësishme si Cana, Lila dhe Roshit që nuk do të jenë në ndeshjen e

radhës. Por ja që ky është momenti jonë" shprehet De Biasi. Kualifikimi? "Sigurisht që oreksi vjen duke ngrënë. Të gjithë do ta dëshironim një gjë të tillë, por më parë duhet të kalojmë Norvegjinë dhe padyshim Islandin që ka futbollistë që luajnë në Premier League. Duhet të jemi me këmbë në tokë, por mund të them që jam i befusuar nga ecuria e Shqipërisë" përfundon De Biasi.

Tifozët Kuqezij kundër veprimeve të Policisë së Shtetit

"Policia na dhunoi si në Guantanamo"

TKZ: Na kërkuan të heqim flamurin e UÇK

Lajmi

Grupimi i Tifozëve Kuqezinj ka akuzuar Policinë e Shtetit se ka ushtruar presion dhe dhunë gjatë ndeshjes me ekipin e Lituanië për të hequr flamurin e UÇK. TKZ dënon këtë akt të dhunshëm sipas tyre dhe kërkon marrjen e masave të menjëhershme.

TIRANE

DYLBER BALLA

Tifozët Kuqezinj" reagojnë kundër veprimeve të Policisë së Shtetit në ndeshjen miqësore me Lituanië që u zhvillua në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa". Grupimi i tifozëve deklaroi se policia ju ka kërkuar që të heqin flamurin e UÇK, pasi në rast të kundërt do të arrestonte. Të zemëruar nga veprimi i policisë, grupimi i tifozëve shprehet i indinjuar duke thënë se po trajtohen si në Guantanamo dhe se kjo është një dyfytërisë e policisë së Shtetit. Më tej mbështetësit më të zjarrtë të kombëtares thonë se nëse kryeministri flet për nacionalizëm dhe atij nuk i hyn gjemb në këmbë e kundërta ndodh me popullin i cili privohet nga e drejta e shprehjes. Ja deklarata e plotë e grupit: Tifozat Kuq e Zi kishin bërë përgatitjet e duhura me rastin e ndeshjes miqësore të 26 marsit kundër Lituanië në Tiranë. Prapaskena e kësaj ishte e errët, këtë e themi pasi tashmë është bërë rutinë që policia e shtetit të silltet në mënyrën më arrogante të mundshme me Tifozat Kuq e Zi. Kordoni i policëve që krijohet brenda tribunës D1 ku vendosen Tifozat Kuq e Zi, të ngjan me ndonjë oborr të Guantanamo së famshëm, gjë e cila nuk ndodh në asnjë stadium të botës. Ne nuk jemi kriminel ordinari, por jemi njerëz që udhëtojmë nga 4 anë e cop-tuara të Shqipërisë Etnike, që lagemi nga shiu, thahemi nga vapa dhe nuk ikim nga



Tifozët kuqezij gjatë ndeshjes me Lituanië

stadium, për një ideal të shenjtë, për dy ngjyra që janë oksigjen për neve. Me këtë rast duam të reagojmë fuqishëm ndaj kësaj policie e cila ka kërcënuar edhe me heqjen e flamurit të UÇK-së në rretho-

jën e stadiumit. Një veprim i pabazuar në asnjë rregullorë e FIFA-s. Kur kjo e fundit është kundërshtuar nga ne, ata kanë kërcënuar me dhunë dhe me masa arresti kundrejt drejtuesve tanë. Nëse kryemi-

nistri flet për nacionalizëm dhe atij nuk i hyn gjemb në këmbë e kundërta ndodh me popullin i cili privohet nga e drejta e shprehjes! Kjo është dyfytërisë e policisë shqiptare në të gjitha ndeshjet. Para

Akuza

Nëse kryeministri flet për nacionalizëm dhe atij nuk i hyn gjemb në këmbë e kundërta ndodh me popullin i cili privohet nga e drejta e shprehjes! Kjo është dyfytërisë e policisë shqiptare në të gjitha ndeshjet.

pak kohësh ne kemi mbajtur një takim me FSHF, dhe jemi thellësisht të dëshpëruar që asnjëra nga pikat që kemi kërkuar në drejtim me hyrjen në stadium dhe policinë nuk është plotësuar. Nuk kërkojmë aspak më tepër, së çfarë kanë tifozëritë europiane atë të respektimit të hapësirës sonë dhe mos prezencën e policisë në ambientin tonë duke u bërë shkak i provokimit kryesor në të gjitha ndeshjet. Të qenit të trajtuar si kriminel ordinari s'mund ta durojmë dot, në të kundërtën Tifozat Kuq e Zi janë të shtrënguar më reagonjë në mënyrën e tyre e cila nuk do jetë mirë për të gjitha palët" përfundon deklarata e tyre.



FSHF:

"Qemal Stafa" pezullohet deri më 7 qershor

Në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa" nuk do të zbrësë në fushë asnjë ekip për asnjë minutë deri më datë 7 qershor, kur do të luajmë përballë Norvegjisë. Kjo do të thotë që ekipet e kryeqytetit Tiranë, Partizani dhe Dinamo duhet të mendojnë seriozisht faktin se ku do të zhvillojnë

ndeshjet e mbetura. Zgjidhjet e momentit janë Yrshëku, fusha e Olimpikut dhe stadiumi "Selman Stërmasi". Vendimi është marrë pas ndeshjes miqësore që u zhvillua më datë 26 përballë Lituanië. FSHF bashkë me bordin drejtues të stadiumit vendosën që të gjitha ndeshjet të pezulloheshin

për shkak të terrenit mjaft të vështirë. Sipas FSHF në dy muajt në vazhdim do të bëhet gjithçka për ta sjellë në kushte optimale fushën në mënyrë që ndeshja e 7 qershorit të zhvillohet në këtë stadium. Me nordikët do të jetë e fundit për ekipin kombëtar të futbollit në "Qemal Stafa".

Morales

Kritikohet për dhuratën e Mesit

Para ndeshjes me ekipin e Boliviës, presidenti i vendit Ivo Morales takoi yllin argjentinas, Mesi në dhomat e zhvishjes dhe i dhuroi veshjen tradicionale të quajtur Poncho, duke marrë në këmbim një fanellë të kombëtares argjentinas. Morales nderoi futbollistin e Barcelonës duke u shprehur se kishte kënaqësinë që të nderonte një nga lojtarët më të fortë të planetit pasi loja e sulmuesit të Barcelonës e impresionon. Por vendimi për të nderuar Mesin përpara ndeshjes me ekipin e tij kombëtar ka sjellë edhe reagimin e futbollistëve të ekipit, që e cilësuan të papranueshëm, pasi vetëm pak minuta më pas Mesi do të luante kundër tyre.



Merkato

Morati fton Murinjon të Interi

Jose Mourinho ka zhvilluar një bisedë telefonike me ish-presidentin e tij të Interi Masimo Morati. Sipas mediave italiane, bosi i Interit e ka telefonuar Mourinjon për të pyetur për të ardhmen. Moratti po mendon seriozisht për zëvendësimin e Stramacionit dhe alternativa më e mirë do të ishte njeriu që i dha kupën e Kampioneve pas afro 20 viteve. Moratti është në kërkim të një trajneri për sezonin e ardhshëm ndërsa rikthimi i Mourinjos do të ishte ëndërr e shumë interesitëve. Edicioni në fund të këtij edicioni me shumë mundësi do të largohet nga ekipi i Realit të Madridit pas përplasjeve me senatorët e merenguesve.




PARADE FJALEKRYQESH

INGIA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV



- HORIZONTAL**
 - 2. Arjen, bomber holandez.
 - 6. Morgana e mbreti Artu.
 - 10. ... devils siç thirren lojtarët e Manchester United.
 - 12. Në hyrje të sallës.
 - 13. Williams teniste.
 - 15. Në krye të evidencës.
 - 17. Të parat në Washington.
 - 19. Satira pa zë.
 - 20. Futbollisti ën foto.
 - 25. Tyson i boksit.
 - 29. Futbollisti në foto.
 - 30. Janë kampionë të skuadrës.
 - 31. Një big match i mundshëm në Champions League.
 - 32. Rolet pa zë.
 - 33. Lewis ish-as i atletikës.
 - 34. Qendër në kaos.
 - 35. Në krye të tabelës.
 - 36. Buffon në portë.
- VERTIKAL**
 - 1. Cantona, ish as i futbollit.
 - 3. Iniciale të Stone regjisor.
 - 4. Në krye të bashkisë.
 - 5. Ekstremet e ndeshjes
 - 6. I keni në dorë
 - 7. Fernando poet portugez
 - 8. Mund të jetë autonom.
 - 9. Një pjesëe lartësisë.
 - 11. Gigi, traimer italian.
 - 14. Meshfushi brazilian që thirrjet Puma
 - 16. Arturo te Juventus.
 - 17. George, ish-bomber i Milan.
- 18. Janë bjeshkët.**
- 21. Një repart në ambulancë.**
- 22. Ndërmarrje Ekonomike Civile.**
- 23. Skuadra e Berlusconi-t.**
- 24. Teket e një salle.**
- 25. Caeres te Juventus.**
- 26. Mauricio, mesfushor tani juventin**
- 27. Një i fundit mbi të gjithë.**
- 28. Ela tase.**
- 29. Louis poet surrealist**
- 33. Manchester i Roberto Mancini-t.**
- 36. Ekstreme gatimi.**
- 37. SHBA në SHBA.**
- 38. Sokoli që kapi topin për gryke.**
- 39. Panik pa kufij.**
- 40. Kufizojnë tatimet.**
- 41. Të fundit në stadium.**
- 42. Janë në qendër.**

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 30 KUTI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																
2																
3																
4																
5																
6																
7																
8																
9																
10																
11																
12																


- HORIZONTAL**
 - 1. Një skelet anijesh.
 - Kush bën... vështron.
 - Një republikë... për kokë.
 - 2. Mund të jenë në natyrë.
 - 3. Takojë fituesit.
 - 3. Ishite altar pagan.
 - Skuadër greke.
 - Howard regjisor.
 - Rrjedh në klepsidër.
 - 4. Emër vajze.
 - Janë punëtorë... për markisistët.
 - 5. Calvino shkrimtar.
 - Një në virtual në computer.
 - 6. Shahu i fundit.
 - Lutofnë par ata që i paguajnë.
 - 7. Italia në Internet.
 - Film i Alfred Hitchcock.
 - Ente Ekonomike Polake.
 - 8. Një gjuajtës ruz.
 - Institucione Doganore
 - Rapelle
 - Që centauri që mësonte Aklin.
 - 9. Roje pa re.
 - Një fjalë si goja.
 - Janë gryka vulkanik.
 - 10. Tapeti për judo.
- VERTIKAL**
 - 1. Ka edhe ai një afat.
 - llosseliani regjisor.
 - 2. Jane perime.
 - Ngrihet nga të ftohtëit.
 - 3. Një tretës me zorrë.
 - Një enë
 - 4. Kështu fillon filmi.
 - Fillojnë ilustrimet.
 - Titulli i Hiri-Hitos.
 - 5. Banushi i paharruar i skenës sonë.
 - Janë edhe ato poe.
 - 6. Lindi Isakun.
 - Iniciale të Ravel.
- Një mund të jetë macchiato.**
- 13. Fare pa fe.**
- Janë zonat e kufizuar.**
- 14. Ishite anija me flamur të zi.**
- Shkroi Në jetë e Jezusit.**
- 15. Janë baballarët.**
- Jepen me leksione.**
- 16. Mc... në Formula 1.**
- Mund të jenë kuzhine.**
- 17. Shteti i francezëve.**
- Një si notkë.**

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



HOROSKOPI nga zozja MERI



DASHI
Sot do jetë një ditë e ngjeshur me shumë veprimtari. Jeta juaj mund të marrë një kthesë e cila me sa duket ka shumë mundësi të ketë të bëjë me punën por dhe me mënyrën se sip o e orazoni jetën tuaj të përditshme. Merruni me dëshitjet tuaj e shëndetit.



LUANI
Me sa duket dita e sotme do vazhdoj për ju të ketë rëndësi në dëshitjet ekonomike. Jo vetëm do flitet për shpenzime por do keni mundësinë të ndjeheni më të sigurt edhe në lidhje me të ardhurat. Në aspektin sentimental gjërat do marrini një drejtim shumë pozitiv.



SHIGJETARI
Për ju do ketë rëndësi karriera si dhe lajme të mira që mund të vijnë nga takime apo kontakte me njerëz të rëndësishëm. Do keni mundësinë e udhëtimit të cilat jo vetëm do jenë qetësuese por edhe frymëzuese për projektet e së ardhmes.



DEMI
Ka shumë mundësi që situata në lidhje me marrëdhënien tuaj me partnerin në cilt të përmirësohen dukshëm përsa i përket planifikimit apo vendimeve të rëndësishme që domemi në këtë drejtim. Lajme të mira vijnë dhe nga fëmijët tuaj të cilëve u plotësohen dëshirat.



VRIGJËRËSHA
Sot Edhe Hëna edhe Merkuri në shenjin tuaj me sa duket ju gjallërojnë sinë e komunikim ashtu edhe në psikologjinë tuaj. Shumë fat dhe lehtësira do sjell dita e sotme dhe sidomos në lidhje me punën dhe marrëdhëniet ligjore dhe familjare.



BRICJAPI
Miq shokë dhe qëllime nga më të rigjeneruarat do ketë dita e sotme për ju. Një takim me një person të rëndësishëm do sjell një kthesë në jetën tuaj të dëshitjes sidomos përsa i përket aksioneve. Në aspektin erotik ju prë një ditë e mrekullueshme.



BINJAKET
Dita e sotme me sa duket do sjell një përmirësim të dukshëm në dëshitjet familjare si dhe do keni takime apo organizoni festa të rëndësishme. Në lidhje me karrierën apo punën do dëgjoni dëshitje që me sa duket nuk do jenë shumë të këndshme.



PESHORJA
Kjo ditë me sa duket nuk do ju gjiej shumë të gatshtëm dhe të përgatitur në lidhje me planet tuaja apo në lidhje me ndryshimet që keni mrenduar të bëni sidomos në aspektin e punës. Në lidhje me shoqerine daljet apo errortzimin gjërat ecin në mënyrë më të ekuilibruar.



UJORI
Dita e sotme me sa duket ka shumë imazhime në planet ekonomike si dhe balancë në jetën sentimentale apo botën tuaj të brendshme. Shpirtërisht do donit të merrni vendime por kjo nuk ndodh për sa kohë nuk pajtoheni me ndjenjat tuaja.



GAFORRJA
Dita e sotme premtori jo vetëm një psikologji më të mirë por edhe një veprimtari më të zgjeruar në fushën e planeve takimeve apo lajmeve të cilat do jenë shumë favorizuese për ju. Këni në dorë fillime të reja prandaj shfrytëzojini mirë njohjet e këtyre ditëve.




AKREPI
Dita e sotme jus jell me sa duket miq dhe shokë të rinj pranë jush dhe kjo sjell si pasojë një rritjeje në aspektet e detyrave dhe qëllimeve që do t'vini vetë. Do keni propozime të rëndësishme pune të cilat duhet ti shikoni me përparesi pasi do kenë zgjidhje.



PESHQIT
Këni një ditë e cila mund të quhet përplasje e titanëve përsa i përket marrëdhënive me të tjerët. Do keni njerëz të fuqishëm përball meqinësë ju jeni bindës në qëndrimet tuaja. Kjo nuk duhet t'u pengojë të bheni tolerant pasi përball ka pengesa të kokavitura.

SUDOKU



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



LAJME NGA BOTA

■ Qipro, sot rihapen bankat në ishullin mesdhetar
 Sot është parashikuar rihapja e bankave në Qipro. Bankat qiprote qëndruan të mbyllura që prej disa ditësh për shkak të panikut të mundshëm të klientëve për të tërhequr depozitat e tyre në sasi të mëdha parash, që nga fillimi i negociatave mes Qipros dhe BE-së për paketën ndihmë prej 10 miliardë eurosh, për të shpëtuar ishullin mesdhetar nga falimentimi financiar. Ndërkohë shefi ekzekutiv i Bankës së Qipros Janis Kypru dhe bordi drejtues i tij janë pushuar me kërkesën e Bankës Qendrore Evropiane dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, ndërsa guvernatori i kësaj banke Panicos Demetriades është kritikuar ashpër për politikën financiare të ndjekura nga institucioni i tij për të përballuar krizën. Bankat shpresojnë që klientët nuk do të kryejnë tërheqje masive të depozitave për shkak të kushteve të ashpra të vendosura nga "Trojka" në dhënien e fondit shpëtues.

■ Koreja e Veriut shton provokimet ndaj fqinjit
 Koreja e Veriut njoftoi djegje të ndërprerë linjën e "kuqes" telefonike me fqinjin jugor. Linja telefonike është instaluar në vitin 1971, si një mjet i komunikimit të drejtpërdrejtë midis dy qeverive në kohë të "tensioneve të mëdha", por që është përdorur gjithashtu për marrëveshjet për shkëmbimin e njerëzve dhe mallrave përtej kufijve të tyre në kompleksin e përbashkët industrial në Kaesong. Siç raporton kanali shtetëror koreano-verior, një luftë mund të shpërthejë në çdo moment. Peniani ka ndërprerë të gjitha marrëveshjet e paqes pasi Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën për ashpërsimin e sanksioneve ndaj Koresë së Veriut, për shkak të zbatimit të testit të ri bërthamor në muajin e kaluar.

■ Turqia kërkon ndryshime në tekste të Kosovës
 Turqia po kërkon me çdo kusht ndryshime në tekste shkollorë të historisë. Madje, diplomacia e këtij shteti në Kosovë është treguar e kujdesshme t'u tërheqë vërejtjen personave që shkruajnë kundër një ideje të tillë. Por, që ka presione të tilla, këtë e mohon Ministria e Arsimit, ndërsa të tjerët tregojnë se kanë pasur rastë kur në zyrë u ka shkruar vetë ambasadorja turke, pasi kanë shkruar kundër ndryshimit të teksteve të historisë. Presioni i shtetit turk për të ndryshuar tekste në librat e historisë vjen edhe nga Ambasada e këtij shteti në Prishtinë.

■ Papa Françesku refuzon apartamentin papnor
 Papa Françesku ka refuzuar apartamentin luksoz ku zakonisht jeton kreu i Vatikanit, duke preferuar të qëndrojë në një rezidencë të thjeshtë me dy dhoma. Zëdhënësi i tij bëri të ditur se Papa po përpiqet që të bëjë një jetë të thjeshtë në komunitet me priftërinjtë e tjerë në rezidencën e Shën Martës në Vatikan, atje ku qëndruan kardinalët gjatë Konklavës. Kështu ai do të ketë mundësi të takojë me shumë njerëz, të shkëmbejë mendime e të ndajë edhe tryezën me ta. Vendim ky që pritej, që kur Ati i Shenjtë hapi apartamentin papnor, me shtatë dhoma dhe një kishëzë private dhe komentoi: Këtu ka vend për 300 vetë!

■ Gjykata e Hagës jep dënime të tjera
 Gjykata e Hagës ka dënuar me 22 vite burg ish-zyrtarët serbo-boshnjakë Miço Stanishiq dhe Stojan Zupljanin, në lidhje me akuzat për krime lufte. Ish-zyrtarët serbo-boshnjakë akuzohen se kanë kryer krime lufte gjatë vitit 1992. Në atë kohë Stojan Zupljanin, ishte zyrtar i lartë në krye të policisë serbo-boshnjake, ndërkohë Miço Stanishiq ka qenë ministër i Brendshëm gjatë luftës në Bosnje.

DIGITALB

TOKESORE KANALI 48

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR KANALI 50

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT: TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



kasketa nga KASTRO ZIZO

çdo të mërkurë dhe të shtunë ora 23:00

NË TELEVISIONIN



Origjina e Lajmit

• Alba Malltezi Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group
 • Anila Basha Drejtore e Shqiptarja.com
 • Edmond Arizaj Kryeredaktor
 • Genc Kondi Zv. Kryeredaktor
 • Politika: Jakin Marena
 Aktualitet: Granit Sokolaj
 Ekonomia: Genc Kondi
 Sociale: Esmeralda Keta
 Kulturë: Admirina Peçi
 Design: Altin Aliaj Genti Manelli
 Website: Suela Gera
 Departamenti i Marketingut: Cel: +355696060419 marketing@shqiptarja.com
 Shpërndarja: Salmir Zeneaj cel: +355696060418 Ermal Kacaniku cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë